



THE SCHOOL DISTRICT OF
PHILADELPHIA

**Udhëzuesi i Shkollave të Mesme
Pranimet vjeshtë 2025**

Tabela e përmbajtjes

Përmbajtja

Këshilla për lundrimin në këtë PDF	3	Abraham Lincoln High School	59
Letër nga Kryeinspektori.....	4	Jules E. Mastbaum AVTS	61
Procesi i përzgjedhjes së shkollës për vitin 2025-2026.....	5	Julia R. Masterman High School	63
Harta e vendndodhjeve të shkollave të mesme.....	6	Motivation High School.....	65
Nxënësit e Anglishtes	7	Northeast High School.....	67
Shërbimet dhe mbështetjet për arsimin e veçantë	8	Northeast H.S. Programi i diplomimit International Baccalaureate	69
Programet akademike dhe të specializuara	9	Northeast High School Magnet Program.....	70
Karriera dhe edukimi teknik (CTE)	12	Olney High School.....	71
21st Century Schools	20	Overbrook High School	73
Atletika.....	21	Parkway Center City Middle College	75
Profilët e shkollave të mesme.....	22	Parkway Northwest HS for Peace and Social Justice	77
Academy at Palumbo High School	23	Parkway West High School	79
Arts Academy në Benjamin Rush High School.....	25	Penn Treaty School	81
John Bartram High School.....	27	Philadelphia High School for Girls	82
William W. Bodine H.S. for International Affairs.....	29	A. Philip Randolph Career Academy	84
Building 21.....	30	Paul Robeson High School for Human Services	85
George Washington Carver HS of Engineering and Science.....	32	Roxborough High School.....	87
Central High School.....	34	Walter B. Saul HS për Shkenca Bujqësore	89
Constitution High School	36	William L. Sayre High School	90
Creative and Performing Arts High School (CAPA).....	37	School of the Future	91
Murrell Dobbins Career & Technical Education High School	38	Science Leadership Academy	93
Thomas A. Edison H.S./John C. Fareira Skills Center	39	Science Leadership Academy Godinat Beeber.....	95
Samuel S. Fels High School.....	41	South Philadelphia High School	96
Frankford High School.....	42	Strawberry Mansion High School	98
Benjamin Franklin High School	44	Swenson Arts and Technical High School	99
Franklin Learning Center High School.....	46	The LINC	100
Horace Furness High School.....	49	The Philadelphia Military Academy.....	101
Girard Academic Music Program (GAMP).....	50	The U School.....	102
Hill-Freedman World Academy High School	51	Vaux Big Picture High School.....	103
Kensington Creative & Performing Arts High School.....	53	George Washington High School	105
Kensington Health Sciences Academy High School	54	G. Washington International Baccalaureate Diploma Program.....	108
Kensington High School	55	West Philadelphia High School	109
Martin Luther King High School.....	56	The Workshop School	111
Lankenau Environmental Science Magnet.....	57	SHTOJCA: Rruga drejt Diplomimit	113

Këshillë për PDF-në:


Përveç përdorimit të hiperlidhjeve në këtë Tabelë të përmbajtjeve, mund të përdorni panelin e faqe-shënuesve ose Skicën e dokumentit për të kaluar nga çdo faqe e këtij dokumenti te një faqe tjetër. [Shikoni faqen tjetër për më shumë informacion.](#)

Këshilla për lundrimin në këtë PDF


Përveç tabelës së përmbajtjes në faqen e mëparshme, mund të përdorni skicën e dokumentit ose faqe-shënuesit për të kaluar nga një faqe në çdo faqe tjetër të këtij dokumenti duke ndjekur këto hapa:

Kur shikoni online:

1. Klikoni në këtë ikonë për të hapur shiritin anësor.




2. Klikoni në këtë ikonë për të treguar skicën e dokumentit.




3. Klikoni në një emër shkolle për të kaluar direkt në atë faqe.

Kur shikoni një pdf të shkarkuar:

1. Klikoni në këtë shigjetë për të hapur shiritin anësor.



2. Klikoni në këtë ikonë për të treguar të gjithë faqe-shënuesit.



3. Klikoni në një emër shkolle për të kaluar direkt në atë faqe.

Tony B. Watlington Sr., Ed.D.
Kryeinspektor

Shtator 2024

Të nderuar nxënës dhe familje të Rrethit Shkollor të Filadelfias,

Udhëzuesi i Shkollave të Mesme 2025-2026 është tani i disponueshëm! Ky është momenti i përsosur për çdo nxënës të klasës së 8-të në Filadelfia që të fillojë të marrë në konsideratë alternativat e tyre për shkollën e mesme. Udhëzuesi i Shkollave të Mesme është një nga mjetet më të mira për t'ju ndihmuar të mësoni rreth programeve që ofrojnë shkollat tona të mesme. Është një burim gjithëpërfshirës për të mbështetur nxënësit dhe familjet në marrjen e vendimeve thelbësore për përzgjedhjen e shkollës së mesme. Ja çfarë do të gjeni në të:

- **Pamja e përgjithshme e Shkollave të Mesme të Rrethit:** Vendndodhjet, ofertat, dhe shumëllojshmërinë e përvajave të disponueshme në qarkun tonë.
- **Programet e disponueshme:** Programe akademike, të specializuara, atletike, jashtëshkollore, dhe Karrierë dhe Edukim Teknik (CTE) në çdo shkollë të mesme.
- **Informacion për pranimet:** Informacion i detajuar në lidhje me kërkesat e pranimeve dhe pritshmëritë akademike për çdo shkollë të mesme.

Ja disa gjëra që duhet t'i merrni parasysh gjatë kërkimit të shkollës më të përshtatshme për ju:

- **Merrni parasysh talentet dhe interesat tuaja:** Cila shkollë ofron programe që përputhen me pasionet tuaja, planet për karrierën dhe pikat e forta akademike?
- **Merrni këshilla:** Konsultohuni me anëtarët e familjes, këshilltarët e shkollave, mësuesit, udhëheqësit dhe të rriturit e tjerë që kujdesen për ju.
- **Vizitoni shkollat që ju interesojnë:** Është ide e mirë të vizitoni shkollën e mesme ku mund të regjistrohëni, të takoni nxënësit, mësuesit, dhe stafin.

Përveç këtij udhëzues, nxënësit dhe familjet e Rrethit Shkollor të Filadelfias inkurajohen të marrin pjesë në aktivitetet në vijim që të mësojnë më shumë për shkollat e rrethit:

Panairi i Shkollave të Filadelfias për arsimin para-universitar (K-12 Philly School Fair) i 2024 do të zhvillohet ditën e premte, 27 shtator nga ora 15:00 deri në orën 18:00, dhe ditën e shtunë, 28 shtator nga ora 10:00 deri në orën 14:00 në Pennsylvania Convention Center – 1101 Arch Street, Philadelphia, PA 19107. Në pPanair, nxënësit dhe familjet mund të njihen me shkollat e mesme publike, shkollat publike të pavarura nga qarku, dhe shkollat private; të mësojnë rreth programeve të ndryshme të shkollave, kërkesat e aplikimit, dhe afatet; mund të bëjnë pyetje; dhe të mbledhin informacion të vlefshëm. Për informacion, vizitoni: www.phillyhighschoolfair.com.

Ditët e shkollave të hapura dhe seancat e informacionit do të zhvillohen në të gjithë Rrethin, në format virtual ose fizikisht. Këto evente do të ofrojnë mundësi më nga afër për të mësuar rreth shkollave specifike dhe eksploruar alternativat e tyre unike.

Dhe në fund, procesi i përzgjedhjes së shkollës Find Your Fit për vitin shkollor 2025-2026 hapet më 13 shtator 2024 në orën 16:00 dhe mbyllet në 23 tetor 2024 në orën 23:59. Për të mësuar më shumë për përzgjedhjen e shkollës, vizitoni www.philasd.org/findyourfit.

Shfrytëzimi i këtyre burimeve mund t'ju ndihmojë të përmirësoni mundësitë tuaja për të gjetur shkollën e mesme më të përshtatshme. Një përvajë pozitive e shkollës së mesme mund t'ju hapë rrugën për sukses në të ardhmen dhe t'u ndihmojë të përmbushni ëndrrat tuaja. Ju uroj gjithë të mirat në kërkimin e shkollës suaj të mesme!

Në partneritet,



Tony B. Watlington Sr., Ed.D.
Kryeinspektor
Rrethi Shkollor i Filadelfias

Procesi i përzgjedhjes së shkollës

për vitin 2025-2026

Procesi i përzgjedhjes së shkollës Fit Your School së Rrethit Shkollor të Filadelfias i lejon nxënësit që janë aktualisht në parashkollor deri në klasën e 11-të të aplikojnë për të frekuentuar çdo shkollë të Rrethit, me hapësirë të disponueshme, jashtë lagjes ose zonës së tyre për vitin e ardhshëm shkollor. **Procesi i përzgjedhjes së shkollës Find Your Fit për vitin shkollor 2025-2026 hapet më 13 shtator 2024 në orën 16:00 dhe mbyllet në 23 tetor 2024 në orën 23:59.**

Gjatë vitit shkollor 2023-2024, Rrethi Shkollor ka vazhduar të marrë përshtypje nga nxënësit dhe familjet në lidhje me përmirësimet e procesit të përzgjedhjes së shkollës. Për rrjedhojë, Zyrat e Regjistrimit dhe Caktimit të Nxënësve (OSEP) dhe të Teknologjisë së Informacionit (IT) kanë bashkëpunuar me një ofrues të ri teknologjie, Avela, për të bërë disa ndryshime bazuar në ato përshtypje. Sistemi i përditësuar rishtazi për përzgjedhjen e shkollës do të ofrojë një proces aplikimi më të efektshëm. **Më 5 gusht, Rrethi prezantoi një mjet më miqësor për përdoruesit për kërkimin e shkollës, të quajtur Explore, që ofron informacion gjithëpërfshirës për çdo shkollë.** Ja çfarë mund të presin nxënësit dhe familjet që planifikojnë të marrin pjesë në procesin e përzgjedhjes së shkollave për vitin shkollor 2025-2026 kur të hapet aplikimi këtë vjeshtë:


- **Në sistemin e ri të përzgjedhjes së shkollës, çdo aplikues do të mund të rendisë pesë zgjedhjet e para të shkollave/programeve një përditësim mjaft i rëndësishëm.** Në vitet e mëparshme, pranueshmëria dhe vendet e disponueshme konsideroheshim pothuajse ekskluzivisht. Ky sistem i ri përdor një algoritëm fitues të Çmimit Nobel, që është projektuar për të gjeneruar ofertën më të mirë bazuar në përshtatshmërinë e një aplikuesi *si dhe* në preferencën e tyre bazuar në mënyrën se si ata i renditën zgjedhjet e tyre të shkollave. **Është e rëndësishme të mos harroni të zgjidhni një total prej 5 shkollash Kufizimi i alternativave nuk do të rrisë mundësitë që të merrni një ofertë – përkundrazi, mundësitë do të ulen.**
- **Aplikuesit mund të marrin një ofertë ose asnjë ofertë gjatë fazës fillestare të përgjigjes.** Ofertat do të bëhen bazuar në rendin në të cilin aplikuesi ka renditur pesë shkollat e tij, përshtatshmërinë e aplikuesit, dhe vendet e disponueshme në shkollë/program.

- **Aplikuesit do të mbeten në listën e pritjes vetëm për shkollat me renditje më të lartë nga të cilat nuk kanë marrë një ofertë.** Për shembull, nëse një nxënës ka renditur pesë shkolla dhe ka marrë një ofertë nga shkolla që ka renditur në vendin e 3-të, ai do të mbetet në listën e pritjes për shkollat e renditura në vendin e 1-rë dhe të 2-të, por do t'u refuzohet automatikisht një vend në shkollat e renditura në vendin e 4-rt dhe të 5-të. Nëse më pas marrin një ofertë për listën e pritjes për zgjedhjen e tyre të 2-të, ata mund ta pranojnë atë ofertë, çka do të refuzojë automatikisht ofertën fillestare të zgjedhjes së tyre të tretë por do t'i lejojë të mbeten në listën e pritjes për zgjedhjen e tyre të 1-rë. Më pas ata mund të zgjedhin një vend për zgjedhjen e tyre të parë, nëse iu ofrohet.
- Preferenca e kodit postar merret ende në konsideratë, por kodet postare kanë ndryshuar pak. Shtatë kodet postare janë **19140, 19133, 19132, 19136, 19124, dhe 19134.**
- Pavarësisht se informacioni i vlerësimit, duke përfshirë PSSA-në, kërkohet ende për të fituar vendet në shkollat bazuara në kritere, **sistemi i aplikimit nuk e pranon më Pennsylvania Alternate System of Assessment (Sistemin alternativ të vlerësimit të Pensilvanisë) (PASA) si një vlerësim të standardizuar të miratuar.**

Rrethi është i emocionuar për këto përditësime në procesin Find Your Fit për përzgjedhjen e shkollës. Sistemi i ri është i projektuar për të trajtuar më mirë preferencën e nxënësit, për t'i ofruar më shumë nxënësve një ofertë fillestare, për të lehtësuar më shumë pranimet në një kohë më të shkurtër, dhe për të rezultuar në reduktimin e përgjithshëm të kohës që do të duhet për të plotësuar një vend të lirë në të gjitha shkollat.

Në vjeshtë, Rrethi do të ofrojë informacion më të detajuar rreth procesit për përzgjedhjen e shkollës Find Your Fit, duke përfshirë periudhat kohore, kriteret, dhe burimet e dobishme. Gjatë kësaj kohe, i ftojme nxënësit dhe familjet të gjejnë përgjigjet e pyetjeve që mund të kenë dhe të mësojnë më shumë për procesin e përzgjedhjes së shkollës duke vizituar schoolselect.philasd.org.

Harta e vendndodhjeve të shkollave të mesme



Zyra e Planit Mësimor dhe Programeve me shumë gjuhë

Aktualisht, në Rrethin Shkollor të Filadelfias janë të regjistruar më shumë se 24 000 Nxënës të Anglishtes (EL) që përfaqësojnë më shumë se 130 shtete që flasin më shumë se 100+ gjuhë në shtëpi. Zyra e Planit Mësimor dhe Programeve me shumë gjuhë (OMCP) mbikëqyr dhe mbështet Programin Arsimit të Mësimi të Gjuhës (LIEP) së Rrethit. Ka tre LIEP të veçanta të hartuara për të plotësuar nevojat e nxënësve me shumë gjuhë:

ESL (English as a Second Language [Anglishtja si Gjuhë e Dytë])

Programi ESL i ndihmon Nxënësit e Anglishtes (EL) të përmirësojnë aftësinë e tyre dhe njohuritë e gjuhës angleze.

Shembujt e mbështetjes së programit ESL mund të paraqiten si:

- Një mësues ESL që udhëheq mësimin
- Një mësues ESL që i bashkohet një klase mësimi të përgjithshëm për të ofruar mbështetje shtesë

Newcomer Learning Academy (NLA)

Newcomer Learner Academy (NLA) ofron një kurs të përshtetshëm studimi që iu mëson anglishten që përdoret në jetën e përditshme dhe në shkollë nxënësve të moshave 14-21 që kanë ardhur së fundmi në Shtetet e Bashkuara.

Programi është hartuar për të përmbushur nevojat e nxënësve të shkollës së mesme që janë të rinj në SHBA dhe të tregojë nivelet fillestare të aftësisë së gjuhës angleze (d.m.th., 1,0-1,9). Përmes kurseve që përfshijnë mësimin e shkrimit dhe leximit të gjuhës me udhëzime në kontekstin e matematikës, shkencës, dhe studimeve shoqërore, nxënësit zhvillojnë aftësitë e gjuhës angleze dhe njohurive në shkrim dhe lexim teksa marrin aftësi dhe njohuri për fushat specifike. Me mbështetjen dhe suportin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm, nxënësit priten të mësojnë përmbajtjet e bazuara në standarde dhe të marrin pjesë në mësimin e tyre në mënyrë aktive. Për nxënësit me ndërprerje ose boshllëqe në arsimin formal, SLIFE (Student with Limited or Interrupted Formal Education [Nxënës me Arsim Formal të Kufizuar ose të Ndërprerë]) — ofrohet mbështetje shtesë përmes detyrave të kursit të specializuara në njohuritë e shkrimit dhe leximit të gjuhës

Kërkesat për pjesëmarrjen në program:

- Qëndrim për më pak se një vit në SHBA **dhe**
- ka një nivel aftësie më të ulët se 2,0

Shkollat e programit NLA:

- Franklin Learning Center
- Frankford HS

Dual Language Programs (Programet Dy-Gjuhëshe)

Programe akademike që mësohen në dy gjuhë. Çdo program që ofron mësimdhënie në lexim e shkrim dhe përmbajtje në dy gjuhë, dhe që nxit zotërimin dhe njohjen e dy gjuhëve, arrijtë akademike sipas nivelit të klasës dhe kompetencën multikulturore për të gjithë nxënësit. (Center for Applied Linguistics, 2016, f.20).

Shkollat me program dy-gjuhësh

- Taylor Elementary
- Lewis Elkin Elementary
- Cayuga Elementary
- Southwark Elementary
- McClure Elementary
- Cramp Elementary
- Muñoz Marin Elementary
- Gloria Casarez Elementary
- Clemente Middle School (*do të bashkohet si shkollë e re e programit në 2024-25*)

Këto programe synojnë të sigurojnë që nxënësit e anglishtes në të gjitha nivelet e aftësisë së gjuhës të mund të angazhohen plotësisht në përmbajtjet rigorozë të nivelit të klasës, të përmbushin standardet e nivelit të klasës, dhe të marrin pjesë në programe mësimore me qasje të barabartë ndaj mundësive të arsimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore, në përputhje me ligjet dhe rregulloret federale dhe të shtetit. OMCP i mbështet të gjitha shkollat në plotësimin e nevojave të nxënësve të anglishtes dhe nxënësve me dy gjuhë nëpërmjet drejtimit të qartë mësimor, mbështetjes së vazhdueshme, udhëheqjes së fortë dhe bashkëpunimit të ngushtë me të gjitha palët.

Për më shumë informacion në lidhje me programet dhe shërbimet e OMCP-së, ju lutemi vizitoni faqen tonë ueb: <https://www.philasd.org/multilingual/>.

Zyra e shërbimeve të specializuara (Office of Specialized Services)

Rrethi Shkollor i Filadelfias ofron një gamë të gjerë shërbimesh dhe mbështetjesh për arsimin për nxënësit me nevoja të ndryshme në shkollat tona. Në përputhje me Ligjin e Arsimit për Individët me Aftësi të Kufizuara dhe Rregulloret e Bordit të Arsimit të Shtetit të Pensilvanisë, Rrethi ofron një program arsimor të përshtatshëm të hartuar për të plotësuar nevojat unike të çdo nxënësi dhe për të mbështetur rritjen akademike, sociale dhe emocionale. Qarku Shkollor i Filadelfias po punon vazhdimisht për të rritur kapacitetin e tij për t'i shërbyer një game më të gjerë nevojash të nxënësve brenda shkollave publike të tij.

Këto shërbime* përfshijnë:

Mbështetje për të mësuar – për fëmijët që kanë më shumë nevojë për mbështetje në fushën e leximit, shkrimit, matematikës ose të folurit ose të dëgjuarit në lidhje me shkollën.

Mbështetje emocionale – për fëmijët që kanë më shumë nevojë për ndihmë sociale, emocionale dhe në sjellje.

Mbështetje për aftësitë e jetës – për fëmijët që kanë më shumë nevojë të mësojnë aftësi akademike, funksionale ose profesionale që do t'i japin mundësinë të jetojnë dhe punojnë në mënyrë të pavarur.

Mbështetje për personat e verbër dhe me probleme shikimi – për fëmijët që kërkojnë shërbime të lidhura me problemet e shikimit ose me verbërinë. IEP për këta nxënës duhet të trajtojë masën në të cilën do të mësohet dhe përdoret gjuha Braille.

Mbështetje për personat që nuk dëgjojnë dhe me probleme të dëgjimit – për fëmijët që kërkojnë shërbime të lidhura me mos dëgjimin ose me probleme të dëgjimit. IEP për këta nxënës duhet të përfshijë një plan komunikimi për të trajtuar nevojat e gjuhës dhe të komunikimit.

Mbështetje për të folurën dhe gjuhën – për fëmijët që kanë probleme me të folurën dhe gjuhën dhe që kërkojnë shërbime për t'i ndihmuar të zhvillojnë aftësitë e komunikimit.

Mbështetje fizike – për fëmijët që kanë një aftësi të kufizuar fizike dhe që kërkojnë shërbime në zhvillimin e aftësive motorike funksionale.

Mbështetje për autizmin – për fëmijët me autizëm që kërkojnë shërbime në fushën e komunikimit, aftësive sociale ose sjelljes.

Mbështetje për aftësi të kufizuara të shumta – për fëmijët me më shumë se një aftësi të kufizuar, kombinimi i të cilave rezulton në pengesa të rënda, dhe që kërkojnë shërbime në aftësitë akademike, funksionale, ose profesionale të nevojshme për një jetë të pavarur.

**Terapia për të folurën/gjuhën, terapia profesionale, terapia fizike, mbështetja për dëgjimin, dhe shërbimet kalimtare ju ofrohen gjithashtu nxënësve të kualifikuar që kërkojnë këto shërbime të ngjashme.*

Një gamë e gjerë ndihmash dhe shërbimesh shtesë për të mbështetur nevojat e nxënësve përfshin pajisjet e komunikimit, teknologjinë ndihmëse, dhe mundësitë para-profesionale.

Zyra e Shërbimeve të Specializuara funksionon brenda Zyrës së Mbështetjeve Akademike së bashku me departamentet e tjera të qarkut shkollor për të mbështetur zbatimin e përshtatshëm të programeve për nxënësit me aftësi të kufizuara. Për më shumë informacion, ju lutemi vizitoni faqen tonë ueb: <https://www.philasd.org/specializedservices/#specializedprograms>.

Shqyrtim individual (Më parë: LeGare)

Nxënësit që kanë një mbështetje IEP, Plan 504, ose janë Nxënës të Gjuhës Angleze, kualifikohen automatikisht për LeGare. Ky është një proces mbështetës që u jep nxënësve një mundësi të BARABARTË për të aplikuar dhe frekuentuar një shkollë të mesme të bazuar në kritere. Ky proces mbështetës zbatohet vetëm për nxënësit e klasave të 8-ta që do të futen në klasën e 9-të.

Duhet të kuptoni që LeGare nuk garanton pranimin në një shkollë të mesme të bazuar në kritere. Nxënësit që kualifikohen për LeGare duhet të plotësojnë ose t'u afrohen kriterëve të pranimin të shkollës së mesme të bazuar në kritere dhe shkolla duhet të jetë në gjendje t'u ofrojë kushte të arsyeshme që nxënësi të jetë i suksesshëm—të gjitha pa ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme mënyrën se si zhvillohet plani mësimor në shkollë. Gjithashtu, është e rëndësishme të siguroheni që shkolla e mesme e bazuar në kritere ku po aplikoni është zgjedhja e duhur për nxënësin tuaj.

Programet akademike dhe të specializuara

Advanced Placement

Kurset e Advanced Placement (AP) janë krijuar për t'u ofruar nxënësve një mënyrë për të fituar kredite kolegji ndërkohë që janë ende në shkollë të mesme. Këto kurse rigorozë të nivelit të kolegjit i ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë aftësi të mendimit kritik, shkrimin akademik si dhe të menaxhimit të kohës. Nxënësit e regjistruar në kurset AP kanë aftësinë të fitojnë kredite kolegji nëse marrin një vlerësim 3 ose më të lartë në provimet AP.

Vendndodhjet: Në të gjithë qytetin

Kontakti: Keysha Jackson, Office of Postsecondary Readiness, 215-400-6276

Frankford
Benjamin Franklin
Franklin Learning Center
Furness
GAMP
Girls
High School of the Future
Hill Freeman
Kensington CAPA
Lincoln
Masterman
Motivation
Northeast
Overbrook
Roxborough
South Philadelphia
Strawberry Mansion
Washington
West Philadelphia
(Ju lutemi, kontaktoni secilën shkollë për t'u siguruar për ofertat e programeve specifike.)

Studime amerikane

Nxënësit fokusohet në një program që thekson studimin përmes përvijës amerikane në partneritet me Qendrën Kombëtare të themelimit (National Constitution Center), Institutin e Historisë Amerikane Gilder-Lehrman (Gilder-Lehrman Institute of American History) dhe firmën ligjore Ballard Spahr.

Vendndodhja: Qendra e themelimit

Akademiti për karrierën

Shikoni përshkrimin e plotë në [seksionin Të gjitha akademitë e shkollës së mesme në faqen 9](#).

Vendndodhjet: Lincoln
Roxborough

Programi i arteve krijuese dhe performuese

Nxënësit mund të fokusohen në artet pamore, që mund të përfshijnë vizatimin, pikturën, skulpturën, qeramikën, krijimin e printimeve, dhe veprat artizanale; dhe në artet interpretuese, që mund të përfshijnë muzikën instrumentale, vokale, kërcimin dhe dramaturgjinë.

Vendndodhjet: Academy at Palumbo
Arts Academy at Benjamin Rush
Bartram
CAPA
Central
Fels

Regjistrim i dyfishtë

Regjistrimi i dyfishtë i ofron nxënësve një mundësi që të plotësojnë detyra kursi me nivel kolegji për të fituar kredite kolegji gjatë kohës që janë të regjistruar në shkollë të mesme. Regjistrimi i dyfishtë ofron kurse rigorozë dhe siguron një prezantim, si dhe përgatit për jetën dhe pritshmëritë e kolegjit. Këto programe ofrojnë një rrugë të përsheptuar drejt kolegjit që iu kursen kohë dhe para nxënësve. Rrethi shkollor mbulon kostot e librave dhe të shkollimit për para maturantët dhe maturantët e shkollës së mesme në kolegjet dhe universitetet pjesëmarrëse.

Vendndodhjet: *Vendndodhja e kolegjeve dhe e universiteteve ndryshon*

Kontakti: Keysha Jackson, Office of Postsecondary Readiness, 215-400-6276

Shërbimet njerëzore

Të gjithë nxënësit, pavarësisht aftësive të tyre, do të sfidohen që të arrijnë potencialin e tyre më të lartë përmes një qasjeje rigorozë dhe humane në shkollë, arte, dhe atletikë.

Vendndodhja: Robeson

Programet akademike dhe të specializuara *vazhdon*

Shkencat e integruara

Nxënësit në Science Leadership Academy (SLA) do të mësojnë në një mjedis të bazuar në projekte ku theksohen vlerat themelore të kërkesës, kërkimit, bashkëpunimit, prezantimit dhe reflektimit në të gjitha klasat. Science Leadership Academy do të ofrojë një plan mësimor rigoroz për përgatitjen për kolegji me një fokus në shkencë, teknologji, matematikë dhe sipërmarrje.

Vendndodhjet: Science Leadership Academy
SLA@Beeber

Marrëdhëniet ndërkombëtare

Nxënësit fokusohen në qeverisjet ndërkombëtare dhe gjuhët e botës në partneritet me World Affairs Council.

Vendndodhja: Bodine

Programi i diplomës International Baccalaureate (IB)

Programet International Baccalaureate (IB) zhvillojnë të rinj kërkues, të ditur dhe të kujdesshëm që janë të motivuar për të pasur sukses. Programi synon të zhvillojë nxënësit që kanë një hapësirë të gjerë dhe të shkëlqyer njohurish. Programet IB punojnë me studentët për të përmirësuar aftësitë e mendimit të tyre kritik, duke mbështetur kureshtjen e tyre dhe aftësinë e tyre për të zgjidhur probleme komplekse.

Vendndodhjet: Bodine
Central
Girls
Hill-Freedman
Northeast
Washington

Kontakti: Keysha Jackson, Office of Postsecondary Readiness, 215-400-6276

Programet Junior ROTC

Nxënësit që marrin pjesë në programet Junior ROTC të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara, Forcave Ajrore ose Marinës që promovojnë patriotizmin dhe zhvillojnë qytetarë të informuar dhe të përgjegjshëm, një shkallë të lartë nderi personal, vetëbesimi, disipline personale, dhe aftësi udhëheqëse.

Vendndodhjet: **FORCAT AJRORE:**

Swenson
USHTRIA:
Frankford
Martin Luther King
Overbrook
Philadelphia Military Academy
Roxborough
South Philadelphia
MARINA:
Benjamin Franklin

Programi i kolegjit të mesëm

Nxënësit do të marrin kurse me një përzierje të nivelit të shkollës së mesme dhe të kolegjit (deri në gjashtëdhjetë e një kredite), duke iu ofruar atyre mundësinë unike për të fituar një diplomë të shkollës së mesme, kredenciale të njohura nga industria dhe/pse një diplomë të asociuar kur diplomohen.

Vendndodhja: Parkway Center City Middle College

Programi Magnet për mjekësinë, inxhinierinë, dhe hapësirën ajrore

Nxënësit marrin mësim përgatitor për kolegjin duke përfshirë kurse të veçanta që fokusohen te mjekësia, inxhinieria dhe teknologjia e hapësirës ajrore dhe marrin pjesë në projektin e njohur në mbarë vendin SPARC, Qendra e Kërkimit Hapësinor (Space Research Center) në një ambient "shkollë-brenda-shkollës".

Vendndodhja: Northeast

Peace Academy

Nxënësit ndjekin një program rigoroz akademik duke përfshirë studimin e paqes, parandalimin e dhunës, dhe drejtësinë sociale. Ata mësojnë teknikat e zgjidhjes së konflikteve, si dhe aftësitë për zgjidhjen e problemeve për të bërë një ndikim pozitiv në nivel lokal dhe global.

Vendndodhja: Parkway Northwest

Shkollat e mesme plotësisht akademike

Qarku shkollor drejton dy shkolla të mesme plotësisht akademike, shkollat e mesme Abraham Lincoln dhe Roxborough. Këto dy shkolla regjistrojnë çdo nxënës në zgjedhjen e tyre të një Akademie të karrierës, që mund të jetë një Edukim për Karrierë dhe Teknik (programi CTE), ose një Akademi me Temë Karriere. Nxënësit janë të përgatitur për hyrjen në kolegji, si dhe për mundësinë e fillimit të karrierave të tyre pas diplomimit nga shkolla e mesme.

Çfarë janë akademitë e karrierës?

Akademitë e karrierës janë komunitete të vogla mësimi të personalizuar brenda një shkolle të mesme. Nxënësit futen në akademi përmes një procesi vullnetar; zgjedhin në cilën akademi duan të marrin pjesë me dijeninë dhe mbështetjen e prindërve. Nxënësit në një akademi të karrierës marrin një përzjerje mësimesh për karrierën (zakonisht një ose dy) dhe akademike (zakonisht tre ose katër) çdo vit. Mësimet përbushin kërkesat e hyrjes për universitetet katër-vjeçar. Nxënësit zhvillojnë njohuritë në një drejtim të caktuar karriere, dhe në shumicën e akademive— ata kanë mundësi të fitojnë certifikime të industrisë lidhur me akademinë e karrierës. Një akademi e karrierës përfshin mësuesi të lëndëve të ndryshme që punojnë së bashku si një ekip. Anëtarët e stafit, që zakonisht ndajnë kohën e përbashkët të planifikimit, punojnë së bashku për të zbatuar veçoritë kyçe të akademisë. Nxënësit mund të grupohen së bashku për disa orë çdo ditë me një grup bazë mësuesish. Kjo promovon një atmosferë si familje dhe rezulton në lidhje të ngushta mes nxënësit dhe mësuesit.

Një akademi e karrierës përfshin elementët në vijim themelor:

- Një komunitet i vogël mësimor i mbështetur nga një komitet këshillues lokal
- Një temë karriere që përfshin një program mësimi përgatitor për kolegjin dhe çon drejt certifikimit të industrisë
- Partneritete me punëdhënësit, komunitetin dhe arsimin e lartë

Si rregull, këta tre elementë qendror të akademisë së karrierës çojnë drejt një shkolle që është rigorozë dhe me emër.

Këto dy shkolla të mesme ofrojnë Akademitë në vijim:

Abraham Lincoln High School

- **Akademia e klasës së nëntë**
- **Akademia e shërbimeve profesionale**
 - Drejtimi i biznesit (CTE)
 - Drejtimi i edukimit në fëmijërinë e hershme
 - Drejtimi i mirëmbajtjes së strukturave dhe pronave (CTE)
 - Drejtimi ligjor
- **Akademia e arteve**
 - Drejtimi i arteve të bukura
 - Drejtimi i Arteve Interpretuese
 - Drejtimi i filmit, videos dhe produksionit (CTE)
- **Akademia e shkencave**
 - Drejtimi i shkencave kompjuterike
 - Drejtimi i shkencave mjedisore
 - Drejtimi i teknologjive të lidhura me shëndetin (CTE)

Roxborough High School

- **Akademia e klasës së nëntë - Akademia e vitit të parë**
- **Akademia e prodhimit të arteve pamore**
 - Prodhimi i filmave dhe videove
 - Dizajn grafik
- **Akademia e shkencave dhe kërkimit për shëndetin**
 - Bioteknologji
 - JROTC
 - Kineziologjia
- **Akademia e teknologjisë së biznesit dhe sipërmarrjes**
 - Administrim biznesi
 - Marketing biznes-sporte
 - Sipërmarrje

Karriera dhe edukimi teknik (CTE)

Programet e studimit

Rreth Karrierës dhe edukimit teknik (CTE)

Programet e Karrierës dhe edukimit teknik (CTE) janë programe studimi një, dy, ose tre vjeçar ku nxënësit regjistrohen si pjesë të karrierës së shkollës së mesme. Nxënësit studiojnë teorinë specifike teknike, kompetencat dhe aftësitë që janë identifikuar nga këshilluesit e industrisë dhe mësohen në strukturat më të mira që reflektojnë teknologjinë dhe pajisjet që përdoren aktualisht në biznes dhe industri. Gjatë kohës që janë të regjistruar në programet CTE, nxënësit angazhohen gjithashtu në një program mësimor akademik përgatitor për kolegjin. Pas diplomimit, nxënësit janë të përgatitur të kalojnë në mundësitë e arsimit pas atij të mesmë (kolegj, universitet, shkolla teknike dhe programe praktike), dhe të pajisur me njohuri të industrisë, kredenciale dhe certifikime që u mundësojnë të fillojnë rrugën e karrierës së tyre në mjediset e shumëllojshme. Programet aktuale që ofrohen për nxënësit e Rrethit Shkollor të Filadelfias përshkruhen më poshtë. Më shumë informacion është i disponueshëm në <https://www.philasd.org/cte/>.

Kontabiliteti

Ky program mësimor është krijuar për të përgatitur nxënësit të ofrojnë mbështetje teknike administrative dhe të eksplorojnë një karriera në kontabilitet dhe/ose menaxhim financiar. Nxënësit mësojnë të përdorin parime përgjithësisht të pranuar të kontabilitetit përmes përdorimit të formateve të kompjuterizuara të kontabilitetit për të përfunduar hapat e ciklit të kontabilitetit për forma të ndryshme të pronësisë së biznesit; të verifikojnë dhe fusin detajet e transaksioneve nga dokumentet fillestare në ditar; të postojnë transaksionet në llogari; të përmbledhin detajet e librit të veçantë duke transferuar të dhënat në librin kryesor; të balancojnë regjistrimet dhe përpilojnë pasqyra financiare dhe raporte të ndryshme financiare; të përgatisin raportet e tatimit në burim, sigurimeve shoqërore dhe raporte të tjera tatimore. Nxënësit e kontabilitetit dalin vullnetarë në zyrat tatimore gjatë sezonit të tatimeve.

Certifikimet e industrisë: IRS Basic Tax Preparer (Përgatitës fillestar i taksave për IRS), Microsoft Office Specialist (Specialist i Microsoft Office) (Excel), QuickBooks Certified User (Përdorues i certifikuar i QuickBooks)
NOCTI: Accounting Basic (Baza e kontabilitetit)
Organizata e nxënësve CTE: DECA dhe FBLA
Vendndodhjet: Dobbins, Lincoln, dhe Washington

Shkencat e kafshëve

Nxënësit fokusohen në shkencat që qëndrojnë pas prodhimeve me burim shtazor dhe shëndetit të kafshëve, përmes aktiviteteve të rregullta praktike me një sërë specimesh—të mëdha dhe të vogla. Mësimi për kafshët e vogla do të përqendrohet në aftësitë e shkencave veterinarë që lidhen me speciet laboratorike dhe shoqëruese (kafshë shtëpiake), ndërsa shumica e kompetencave të nxënësve për kafshët e mëdha (lopë, dele, kuaj dhe derr) do të bazohet në kohën e kaluar në fermën e punës që është pjesë e kampusit të shkollës. Edukimi në fushën e shkencës së kafshëve i përgatit nxënësit për mundësi në fusha si sjellja dhe mbarëshëmtimi i kafshëve, prodhimi i ushqimit dhe i fibrave, ushqyerja, agrobiznesi i kafshëve, mirëqenia e kafshëve, teknologjia veterinarë, kërkimi dhe bioteknologjia.

Certifikimet e industrisë: OSHA Agriculture (OSHA për bujqësinë), OSHA Veterinary (OSHA për veterinarinë)
NOCTI: (nuk ka - kërkesë e tërhequr nga shteti)
Organizata e nxënësve CTE: FFA
Vendndodhja: Saul

Skicim dhe projektim arkitekturor

Ky program mësimor i përgatit nxënësit të zbatojnë dijet dhe njohuritë teknike të parimeve shkencore, koncepteve matematikore dhe aftësive komunikuese dhe teknike, duke përfshirë CAD, të kombinuara me përvojat laboratorike, të cilat janë mbështetëse për arkitektin dhe inxhinierin arkitekturor. Kjo temë ka të bëjë me zhvillimin e planeve për ndërtesat dhe strukturat e tjera duke përdorur materiale të ndryshme ndërtimi dhe skica dhe planimetri krijuese që janë në përputhje me kodet e ndryshme të ndërtimit, ligjet e zonave si dhe rregulloret dhe urdhrat e tjerë. Kjo përpjekje duhet të jetë në përputhje me kufizimet e kostos, si dhe me preferencën e klientit për sa i përket stilit dhe planit duke vënë në dukje formën e artit. Punëtori e ndihmon arkitektin gjatë inspektimeve për t'u siguruar që skica nuk është ndryshuar dhe se materialet e përdorura përputhen me specifikimet e kontratës, kryesisht në fushën e ndërtimit të ndërtesave.

Certifikimet e industrisë: OSHA 10 Construction (OSHA 10 për ndërtimin), Autodesk, Certified Drafter (Projektues i certifikuar)
NOCTI: Projektim arkitekturor
Organizata e nxënësve CTE: Skills USA
Vendndodhja: West Philadelphia

Përplasja dhe riparimi i trupave të automjeteve

Nxënësit mësojnë të ekzaminojnë automjetet e dëmtuara dhe të vlerësojnë koston e riparimeve. Duke ndjekur procedurat I-CAR të njohura nga industria, ata mësojnë të riparojnë shtypjet në makinë; të heqin dhe zëvendësojnë parafangot, panelet, grilat dhe të montojnë parakolpin e dëmtuar. Mësohet gjithashtu

zëvendësimi ose riparimi i tapicerisë, aksesoreve, pajisjeve elektrike dhe hidraulike të dritareve dhe ndenjësive, si dhe të xhamit. Teoria përfshin projektimin dhe ndërtimin e automjeteve, drejtimin e strukturës, përgatitjen së sipërfaqes, sigurianë dhe sistemet e kontrollit, si dhe përdorimin e veglave elektrike dhe manuale. Mësohen gjithashtu teknikat bazë të saldimit Mig, saldimit me pikë, dhe saldimit të plastikës. Nxënësit bëjnë rifiniturën e sipërfaqeve të riparuar në një kabinë për lyerjen dhe mësojnë të aplikojnë astarin, finiturën, dhe shtresën e bojës së tejdukshme. Nxënësit do të praktikojnë vetë teknikat e smerilimit, lëmimit, dhe pastrimit të bojërave si dhe teknikat e detajimit.

Certifikimet e industrisë: Intro to Vehicle Parts Terminology (Hyryje në terminologjinë e pjesëve të automjeteve), Intro to Tools (Hyryje në vegla), Equipment and Attachment Methods (Pajisjet dhe metodat e ngjitjes), S/P2 (të shumta)

NOCTI: Teknologjia e riparimit nga përplasja dhe e rifiniturës
Organizata e nxënësve CTE: Skills USA

Vendndodhjet: Edison, Randolph, Swenson, dhe Workshop

Teknologji automobile

Ky program mësimor i përgatit nxënësit të zbatojnë njohuritë dhe aftësitë teknike në riparimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha llojeve të automjeteve dhe kamionëve të lehtë. Praktika nga vetë nxënësi përfshin rregullat e sigurisë, përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale, praktikat profesionale të punishteve dhe përdorimin e veglave manuale dhe elektrike. Ky program përfshin udhëzime për gjetjen e problemeve të automjeteve dhe testimin e defekteve, dhe riparimin e sistemeve të karburantit, elektrike, ftohjes dhe frenave. Gjithashtu, mësohet si përdoren dhe riparohen motorët, transmisioni, dhe sistemet e drejtimit dhe të amortizimit. Nxënësit mësojnë përdorimin e informacionit të riparimit teknik, të veglave dhe burimeve standarde të industrisë.

Certifikimet e industrisë: S/P2 (të shumta)

NOCTI: Teknologjia e pjesëve mekanike të automjeteve PA
Organizata e nxënësve CTE: Skills USA

Vendndodhjet: Edison, Mastbaum, Randolph, Swenson, dhe Workshop

Arti i pjekjes dhe ëmbëlsirave

Programet e arteve të pjekjes dhe ëmbëlsirave ju ofrojnë nxënësve përvojë praktike dhe trajnim bazë teorik për ëmbëlsirat, pastat, karamelat, punët dekorative, bukët speciale ose artizanale, prodhimin në sasi të mëdha dhe marketingun ushqimor. Drejtimi i karrierës së nxënësve mund të përfshijë gjithashtu bufetë në anijet e pushimeve, banketet në rezort, prodhimin e karamelave, dekorimet e tortave për raste të veçanta dhe dasma, prodhimin e ëmbëlsirave dhe bukës për restorante, punimet artistike të çokolletës, bufetë dhe ëmbëlsirat në pjata, pastat klasike dhe evropiane, ekspozita pasticerie dhe konkurse me pasta.

Certifikimet e industrisë: ServSafe Food Handler and Manager (Trajtues dhe menaxher i produkteve ushqimore ServSafe), Food Safety (Siguria ushqimore)

NOCTI: Pjekje me pakicë për tregtim

Organizata e nxënësve CTE: DECA

Vendndodhja: Swenson

Kursi për berber

Ky program mësimor i përgatit individët të rruajnë dhe të shkurtojnë flokët dhe qimet e qafës dhe mjekrën, të presin dhe të stilojnë flokët, të vendosin paruke, të bëjnë masazhe të fytyrës dhe të kokës, të aplikojnë trajtime të lëkurës dhe të përgatiten për licencimin si berberë profesionistë. Mësimi

përfshin rruajtjen e fytyrës; dhënien e formës dhe shkurtrimin e mjekrës dhe mustaqeve; larjen e flokëve; prerjen e flokëve; prerjen e modeleve të flokëve dhe stilimin; trajtimet e fytyrës dhe masazhet; trajtimet kimike; anatominë dhe fiziologjinë e flokëve dhe skalpit; vendosjen e parukave dhe të parukave të pjesshme; përdorimin e pajisjeve; shëndetin dhe sigurinë; shërbimin ndaj klientit; si dhe praktikën e biznesit të berberëve. Menaxhimi i salloneve dhe i produkteve, duke përfshirë mbajtjen e inventarëve dhe marrëdhëniet me klientët, është një nga pikat ku fokusohet plani mësimor. Nxënësit gjithashtu marrin udhëzime për sa i përket ofrimit të shërbimeve për klientët me sëmundje kronike dhe me nevoja të veçanta, si dhe eksplorojnë karriera të mundshme në Industrinë e Shëndetit. Për t'i përgatitur nxënësit në mënyrë të përshtatshme për punësimin në këtë industri, këto programe u përbahen të gjitha standardeve etike dhe profesionale të industrisë, siç janë miratuar nga PA State Board of Barber Examiners (Bordi shtetëror i kontrolluesve të berberëve të PA-së). Nën mbikëqyrjen e një instruktori të licencuar dhe të kualifikuar, nxënësit marrin pjesë në ushtrimin e aktivitetit të dyqanit të një berberi që mëson nxënësit, dhe kujdesen për klientë të vërtetë për të fituar aftësitë e shërbimit ndaj klientit dhe të menaxhimit që kërkohen për t'u bërë profesionistë të kualifikuar në këtë industri emocionuese. Përveç kësaj, nxënësit zhvillojnë praktikën pranë dyqaneve të berberëve për të fituar trajnime dhe përvojë të vlefshme në vendin e punës. Mësimi është krijuar për t'i kualifikuar nxënësit për provimin e licencimit të PA State Board of Barber Examiners (Bordi shtetëror i kontrolluesve të berberëve të PA-së).

Certifikimet e industrisë: PA State Board of Barber Examiners (Bordi shtetëror i kontrolluesve të berberëve të PA-së), OSHA 10

NOCTI: (nuk ka - kërkesë e tërhequr nga shteti)

Organizata e nxënësve CTE: Skills USA

Vendndodhja: Dobbins

Bioteknologji

Nxënësit në këtë program do të mësojnë se si përdoren veglat dhe teknikat shkencore për të ndihmuar në përmirësimin e jetës sonë dhe shëndetin e planetit tonë. Nxënësit do të eksplorojnë studimin e gjenetikës, mikrobiologjisë, strukturën dhe funksionin e ADN-së, mjekësinë ligjore, bioetikën dhe orkestrimin përmes laboratorëve praktik, të botës reale dhe eksperimenteve. Aftësitë e mbuluara do të variojnë nga përgatitja e solucioneve dhe përdorimi i pipetave të transferimit deri te teknikat më të avancuara në kultivimin e qelizave, izolimin dhe pastrimin e proteinave, procedurat e ndarjes, kromatografinë dhe elektroforezën me xhel. Të diplomuarit në fushën e bioteknologjisë do të zbulojnë se aftësitë e tyre janë të kërkuara në ndërmarrjet farmaceutike/mjekësore, të teknologjisë mjedisore dhe ushqimore që kërkojnë të krijojnë dhe përmirësojnë produkte dhe procese të ndryshme.

Certifikimet e industrisë: BLS for Healthcare Providers-CPR & AED (BLS për Ofruesit e Kujdesit Shëndetësor- CPR & AED), OSHA 10 Healthcare (OSHA 10 për shëndetësinë)

NOCTI: Bioteknologji

Organizata e nxënësve CTE: Skills USA

Vendndodhjet: Dobbins dhe Roxborough

Administrim biznesi

Ky program mësimor është krijuar për t'i përgatitur nxënësit që të mësojnë dhe të punojnë në punë të ndryshme biznesi dhe zyre/administrative. Nxënësit do të trajnohen dhe do t'i nënshtrohen certifikimit Word dhe Excel (MOS) dhe provimeve Quickbook. Nxënësit do të fitojnë njohuri të strukturës së biznesit/zyrës dhe

se si ajo lidhet me llojet e ndryshme të organizatave të biznesit, dhe nxënësit do të fillojnë të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për të pasur sukses si punonjës të ardhshëm në organizata të ndryshme të lidhura me zyrën. Mësimi përfshin komunikimin e biznesit, kontabilitetin, parimet e biznesit, ekonominë, etikën, ligjin, futjen e të dhënave, procedurat e zyrës, kontabilitetin, menaxhimin e regjistrave dhe përgatitjen e raporteve.

Certifikimet e industrisë: Microsoft Office Specialist (Word & Excel) and NRF (National Retail Federation) Customer Service & Sales (Specialist i Microsoft Office (Word & Excel) dhe Shërbimi ndaj klientit dhe shitjeve NRF (Federata Kombëtare e Shitjes me Pakicë))
NOCTI: Asistent administrativ PA
Organizata e nxënësve CTE: FBLA/DECA
Vendndodhjet: Franklin Learning Center, King, Lincoln, dhe Roxborough

Zdrukthëtari

Ky program mësimor i përgatit nxënësit të zbatojnë njohuritë dhe aftësitë teknike për të rregulluar, fabrikuar, ngritur, instaluar dhe riparuar strukturat dhe instalimet duke përdorur vegla manuale dhe elektrike. Ky program përfshin mësimin për sistemet e zakonshme të inkuadrimin, materialeve të ndërtimit, vlerësimit, leximit të planeve dhe teknikave të finiturës së zdrukthëtarisë.

Certifikimet e industrisë: OSHA 10 për ndërtimin, HBI/Akademia për ndërtimin e banesave (zdrukthëtaria)
NOCTI: Zdrukthëtari
Organizata e nxënësve CTE: Skills USA
Vendndodhjet: Mastbaum dhe Swenson

Programimi kompjuterik

Ky program mësimor fokusohet në shkrimin dhe zbatimin e përgjithshëm të programeve të përgjithshme dhe të personalizuar për të ekzekutuar sistemet operative dhe i përgatit individët në mënyrë të përgjithshme për të zbatuar metodat dhe procedurat e projektimit dhe programimit të softuereve për instalimin dhe mirëmbajtjen e softuereve. Përfshin mësimin për projektimin e softuerit, gjuhët e nivelit të ulët dhe të lartë dhe shkrimin e programeve; personalizimin dhe lidhjen e programit; testimin e prototipit; zgjidhjen e problemeve; dhe aspektet përkatëse të sistemeve operative dhe të rrjeteve.

Certifikimet e industrisë: Python
NOCTI: Programimi kompjuterik
Organizata e nxënësve CTE: Skills USA
Vendndodhja: School of the Future dhe Washington

Teknologji e sistemeve kompjuterike

Ky program mësimor i përgatit nxënësit të aplikojnë aftësitë e mbështetjes teknike dhe të shërbimit ndaj klientit për të ndihmuar përdoruesit e kompjuterit dhe për të gjetur zgjidhjen për problemet që ata përjetojnë. Nxënësit mësojnë bazat e dizajnit kompjuterik dhe sistemeve të informacionit. Ata gjithashtu mësojnë të gjejnë dhe të zgjidhin problemet e harduerit dhe softuerit, të riparojnë sistemet dhe të përgatisin raporte dhe dokumentacione të tjera. Praktika e vlefshme me riparimin dhe mirëmbajtjen e kompjuterit është një pjesë thelbësore e programit.

Certifikimet e industrisë: IT Fundamentals (Bazat e IT-së), PC Pro (TestOut), Tech+/IT Fundamentals (Bazat e Tech+/IT), A+ (CompTIA), OSHA 10 (e përgjithshme)
NOCTI: Teknologjia e kompjuterëve/ sistemet kompjuterike PA
Organizata e nxënësve CTE: Skills USA
Vendndodhjet: Kensington dhe South Philadelphia

Lidhje e rrjetit kompjuterik

Ky program mësimor fokusohet në projektimin, zbatimin dhe menaxhimin e kompjuterëve të lidhur, pajisjeve periferike dhe softuereve të lidhur. Programi përfshin mësimin për të kuptuar sistemet operative dhe aplikacionet; instalimin e pajisjeve, softuereve dhe komponentëve të rinj; identifikimin e shkaqeve të problemeve të lidhjes së rrjetit; dhe përdorimin e softuerit dhe pajisjeve të testimit të gjatjes së problemeve për të zgjidhur problemet e rrjetit.

Certifikimet e industrisë: Tech+/IT Fundamentals (Bazat e Tech+/IT), IT Fundamentals Network Pro (IT Bazat e Network Pro (TestOut)), Network + (CompTIA)
NOCTI: Lidhja e rrjetit të sistemeve kompjuterike PA
Organizata e nxënësve CTE: Skills USA
Vendndodhjet: Swenson dhe West Philadelphia

Teknologji e ndërtimit

Ky program mësimor i përgatit individët që të zbatojnë njohuritë dhe aftësitë në fushën e teknologjisë së ndërtimit. Ofrohen mësimin për aftësitë bazë në një sërë fushash që lidhen me ndërtimin e ndërtesave si zdrukthëtaria, ndërtimi i mureve, sistemet hidraulike, sistemet e ngrohjes dhe elektrike. Mësimi përfshin, por nuk kufizohet në leximin e planeve; vlerësimin e kostos; përdorimet e veglave manuale dhe elektrike; prerjen, montimin, fiksimin dhe finiturën e materialeve të ndryshme; dhe zbatimin e specifikimeve teknike dhe njohurive në lidhje me vetitë fizike të materialeve.

Certifikimet e industrisë: Forklift Operator (Operator i pirunit), OSHA 10 Construction (OSHA 10 për ndërtimin), HBI/ Residential Construction Academy Building Construction Tech (HBI/Akademia për ndërtimin e banesave Tekn. e ndërtimit të banesave)
NOCTI: Profesionet e ndërtimit të banesave
Organizata e nxënësve CTE: Skills USA
Vendndodhja: Randolph

Kozmetika

Ky program mësimor i përgatit individët që të zbatojnë njohuritë dhe aftësitë teknike të lidhura me përvojat në një sërë trajtimeve bukurie, duke përfshirë kujdesin dhe përmirësimin e gjendjes së flokëve, lëkurës dhe duarve. Udhëzimi përfshin trajnimin në larjen e flokëve, shpëlarjeve dhe trajtimeve të skalpit; stilimin, rregullimin, prerjen, lyerjen, ngjyrosjen dhe dekolimin e flokëve; bërjen e kaçurrelave permanente; trajtimeve të fytyrës; manikyrin; dhe masazhimin e duarve dhe krahëve. Bakteriologjia, anatomia, higjiena, sterilizimi, menaxhimi i salloneve dhe i produkteve, duke përfshirë mbajtjen e inventarëve dhe marrëdhëniet me klientët, janë disa nga pikat ku fokusohet plani mësimor. Nxënësit gjithashtu marrin udhëzime për sa i përket ofrimit të shërbimeve për klientët me sëmundje kronike dhe me nevoja të veçanta, si dhe eksplorojnë karriera të mundshme në Industrinë e Shëndetit. Për t'i përgatitur nxënësit në mënyrë të përshtatshme për punësimin në industrinë e flokëve dhe të bukurisë, këto programe iu përmbahen të gjitha standardeve etike dhe profesionale të industrisë, siç janë miratuar nga PA State Board of Cosmetology. (Bordi shtetëror i kozmetikës së PA-së). Nën mbikëqyrjen e instruktorëve të licencuar dhe të kualifikuar, nxënësit marrin pjesë në ushtrimin e aktivitetit real të një salloni që mëson nxënësit, dhe kujdesin për klientët të vërtetë për të fituar aftësitë e shërbimit ndaj klientit dhe të menaxhimit që kërkohen për t'u bërë profesionistë në këtë industri emocionuese. Përveç kësaj, nxënësit zhvillojnë praktikën pranë salloneve për të fituar trajnimin dhe përvojë të vlefshme në vendin e punës. Mësimi është krijuar për t'i kualifikuar nxënësit për provimin e licencimit të PA State Board of Cosmetology (Bordi Shtetëror i kozmetikës së PA-së).

Certifikimet e industrisë: PA State Board of Cosmetology (Bordi Shtetëror i kozmetikës së PA-së).
Licencë, OSHA 10
NOCTI: Kozmetika PA
Organizata e nxënësve CTE: Skills USA
Vendndodhjet: Dobbins dhe Edison

Artet e kulinarisë

Ky program mësimor i përgatit nxënësit për punësim e lidhur me ndërmarrjet ushqimore institucionale, tregtare ose private, ose profesione të tjera të industrisë ushqimore. Mësimet dhe përvojat e veçanta të mësimi përfshijnë teorinë, përvojën në laborator dhe në punë në lidhje me planifikimin, përzgjedhjen, përgatitjen dhe shërbimin e ushqimit dhe produkteve ushqimore cilësore; vlerat ushqyese; përdorimin dhe kujdesin për pajisjet tregtare; sigurinë; dhe masat paraprake sanitare. Mësimet për aftësitë ju ofrohen gjithashtu individëve që dëshirojnë të punësohen në çdo fushë të industrisë së shërbimit të ushqimit në nivelin fillestar.

Certifikimet e industrisë: ServSafe Food Handler and Food Safety Manager (Trajtues i produkteve ushqimore Servsafe dhe menaxher i sigurisë ushqimore)
NOCTI: ACF, Shef i Arteve të Kulinarisë/ACF
Organizata e nxënësve CTE: DECA
Vendndodhjet: Dobbins, Edison, Frankford, Benjamin Franklin, King, Mastbaum, Randolph, South Philadelphia, Strawberry Mansion, Swenson, dhe Washington

Asistent dentar

Ky program mësimor i përgatit nxënësit të punojnë në mënyrë efektive si një anëtar thelbësor i ekipit të shëndetit dentar. Praktikanti do të asistojë duke qëndruar pranë karriges së dentistit, do të kryejë detyrat përkatese të klinikës, procedurat e zgjedhura laboratorike të klinikës dentare dhe radiografinë dentare nën mbikëqyrjen e një dentisti të licencuar. Kurset e planifikuara duhet të përfshijnë mësimet për masat paraprake universale, rregulloret e OSHA-së, aftësitë e komunikimit, njohuritë kompjuterike, psikologjinë, anatominë dhe fiziologjinë, mikrobiologjinë dhe ushqyerjen. Mësimi i Shkencave Stomatologjike do të përfshijë përmbajtje si materialet dentare, radiografia dentare, anatomia orale, histologjia, embriologjia orale, patologjia orale dhe terapeutikët. Shkenca klinike duhet të theksojë parimet dhe zbatimin e menaxhimit të zyrës, asistencës pranë karriges, urgjencave dentare dhe aspekteve ligjore/etike të praktikës dentare. Praktika klinike është një pjesë thelbësore e programit të krijuar për të përsosur kompetencën e nxënësve në kryerjen e funksioneve të ndihmës dentare.

Certifikimet e industrisë: Bloodborne Pathogens (Patogjenët që vijnë nga gjaku), BLS Healthcare Provider CPR & AED (Ofruesi i Kujdesit Shëndetësor BLS CPR & AED (American Heart Association [Shoqata Amerikane e Zembrës])), ICE Infection Control (Provimi i kontrollit të infeksionit (ICE) (Dental Assisting National Board [Bordi kombëtar i asistencës dentare])), Heartsaver First Aid (Ndihma e parë Heartsaver), HIPAA, OSHA Healthcare (OSHA për shëndetësinë), Radiation Health and Safety (Shëndeti dhe siguria ndaj rrezatimit (RHS))
NOCTI: Asistencë dentare
Organizata e nxënësve CTE: HOSA
Vendndodhja: Kensington Health Sciences Academy

Prodhim i mediave dixhitale

Mësimi në këtë program përfshin, por nuk kufizohet në, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e sistemit kompjuterik, funksionimin e aplikacioneve kompjuterike bazë dhe të

komunikimit, dizajnin, paraqitjen e imazheve grafike dhe të multimedis, fotografinë, faqet e uebit, dizajnin video dhe/ose audio dhe prodhimin. Nxënësit gjithashtu mësojnë të konfigurjnë dhe përdorin pajisje audio dhe video, duke përfshirë mikrofonat, altoparlantët, ekranet video, monitorët video dhe pajisjet e regjistrimit. Specialistët e Prodhimit të Mediave Dixhitale ofrojnë shërbime në fusha të ndryshme që lidhen me tipografinë, ueb-in dhe dizajnin grafik, videon, audion, prodhimin televiziv, animacionin dhe fotografinë. Nxënësit në këtë program do të ekspozohen ndaj një shumëllojshmërie fushash aftësish në mënyrë që të specializohen në një karrierë të ngjashme, si dizajni grafik, dizajni i uebit, videografia, fotografia dhe animacioni dixhital.

Certifikimet e industrisë: Adobe Certified Associate (Përdorues i certifikuar i Adobe (Premiere Pro, Photoshop, InDesign, Illustrator, dhe/ose Dreamweaver))
NOCTI: Teknologjia e komunikimeve PA
Organizata e nxënësve CTE: Skills USA
Vendndodhjet: CAPA, Dobbins, Kensington CAPA, Northeast, Olney, Overbrook, Swenson, dhe West Philadelphia

Edukimi në fëmijërinë e hershme

Ky program mësimor i përgatit nxënësit për një sërë profesionale të lidhura me kujdesin dhe mësimin e fëmijëve, shpesh nën mbikëqyrjen e personelit profesional në qendrat e kujdesit për fëmijë ose të përkujdesit ditor. Ky program përfshin mësimet për rritjen dhe zhvillimin; ushqyerjen; planifikimin dhe menaxhimin e programit; sigurinë; udhëzimin për sjelljen; aktivitetet me lojëra; abuzimin dhe neglizhimin e fëmijëve; marrëdhëniet personale prind-fëmijë; përvojat e mësimi për fëmijët; dhe ligjet, rregulloret dhe politikat në lidhje me shërbimet e kujdesit për fëmijët.

Certifikimet e industrisë: Infant & Child CPR (CPR për foshnjat dhe fëmijët), Child Development Associate (Bashkëpunëtor i zhvillimit të fëmijëve (CDA)), Babysitting Basics (Bazat e kujdesit për fëmijët (American Red Cross [Kryqi i Kuq Amerikan])), Babysitting Training (Trajnim për kujdesin për fëmijët (American Red Cross [Kryqi i Kuq Amerikan])), BLS Healthcare Provider (Ofruesi i kujdesit shëndetësor BLS)
NOCTI: Shërbimet e kujdesit dhe mbështetjes për fëmijët PA
Organizata e nxënësve CTE: HOSA
Vendndodhja: Parkway West

Arsimi

Ky program ju siguron nxënësve njohuri dhe një vlerësim të profesionit të mësuesit duke eksploruar karriera në fushën e arsimit dhe trajnimit dhe degët e lidhura me to. Nxënësit do të fillojnë të ndërtojnë një themel për mësimdhënien; do të mësojnë historinë, strukturën dhe menaxhimin e mësimdhënies dhe do të mësojnë rreth teknikave profesionale të mësimdhënies në klasë. Ky program ofron mundësi praktike për nxënësit që të shqyrtojnë karrierën në arsim, të ndjekin praktikën profesionale dhe të zbatojnë standardet profesionale dhe teorinë mësimore. Në një përvojë praktike autentike, nxënësit do të mund të praktikojnë dhënien e mësimi, të mësojnë teknikat e menaxhimit të klasës, të krijojnë mundësi mësimi, si dhe të krijojnë portofolin e tyre profesional gjatë këtij procesi.

Certifikimet e industrisë: OSHA 10 (e përgjithshme), Heartsaver First Aid (Ndihma e parë Heartsaver), Heartsaver CPR & AED
NOCTI: (nuk ka—kërkesë e tërhequr nga shteti)
Organizata e nxënësve CTE: FCCLA
Vendndodhjet: SLA Beeber dhe Olney

Përcimi elektrik dhe i energjisë

Ky program mësimor i përgatit nxënësit të zbatojnë njohuritë dhe aftësitë teknike të nevojshme për instalimin, funksionimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e sistemeve elektrike rezidenciale, tregtare dhe industriale, si dhe motorët DC dhe AC, çelësat dhe panelet e shpërndarjes elektrike. Mësimi i jep rëndësi zbatimit praktik të matematikës, shkencës, diagrameve të qarkut dhe përdorimit të kodeve elektrike dhe përfshin leximin e planeve, skicimin dhe lëndë të tjera që janë thelbësore për punësimin në profesionet elektrike. Leximi dhe interpretimi i kodeve dhe specifikimeve të instalimeve elektrike për ndërtesat tregtare dhe rezidenciale, instalimi dhe mirëmbajtja e instalimeve elektrike, rrjetëve të shërbimit dhe shpërndarjes brenda komplekseve të mëdha të ndërtimit janë gjithashtu komponentë shumë të rëndësishëm të programit.

Certifikimet e industrisë: OSHA 10 Construction (OSHA 10 për ndërtimin), HBI/ Residential Construction Academy House Wiring (HBI/ Akademia për ndërtimin e banesave - Lidhja e instalimeve elektrike në banesa)
NOCTI: Instalues të përcimit elektrik dhe të energjisë PA
Organizata e nxënësve CTE: Skills USA
Vendndodhjet: Edison, Mastbaum, dhe Swenson

Teknik për urgjencat mjekësore

Firefighter Training Academy i përgatit nxënësit për certifikim dhe karrierë si teknikë për urgjencat mjekësore dhe zjarrfikës. Një program që përgatit individët, nën mbikëqyrjen në distancë të mjekëve, që të njohin, vlerësojnë dhe menaxhojnë urgjencat mjekësore në mjediset paraspitalore dhe për të mbikëqyrur personelin e ambulancës. Përfshin mësim për procedurat bazë, të ndërmjetme dhe të avancuara të EMT-së; procedurat kirurgjikale urgjente; triazhin mjekësor; operacionet e shpëtimit; menaxhimin e situatës së krizës dhe mbikëqyrjen e personelit; përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve; stabilizimin, monitorimin dhe kujdesin e pacientit; administrimin e barnave; identifikimin dhe diagnostikimin paraprak të sëmundjeve dhe lëndimeve; komunikimin dhe shërbimet kompjuterike; anatominë bazë, fiziologjinë, patologjinë dhe toksikologjinë; dhe standardet dhe rregulloret profesionale.

Certifikimet e industrisë: EMT, FireFighter I (Zjarrfikës I), Heartsaver First Aid (Ndihma e parë Heartsaver), First Responder (Ndihma e parë), Hazmat Awareness (Ndërgjegjësimi për materialet e rrezikshme), Hazmat Operations (Shërbimet me materiale të rrezikshme), HIPAA, Incident Command (Zotërimi i incidenteve)
NOCTI: (nuk ka—kërkesë e tërhequr nga shteti)
Organizata e nxënësve CTE: HOSA
Vendndodhja: Randolph

Teknologji Inxhinierike

Ky program mësimor u ofron nxënësve një bazë për studime të mëtejshme të llojeve të shumta të inxhinierisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në inxhinierinë mekanike, elektrike, industriale, civile, kimike dhe mjedisore. Nxënësit do të mësojnë rreth temave si: siguria, etika, zgjidhja e problemeve, puna në grup, grafika për inxhinierinë, sistemet e automatizuara, pajisjet elektronike, prodhimin e avancuar, robotikën, dhe më shumë. Detyrat e kursit i përbahen iniciativës STEM (shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë)

Certifikimet e industrisë: Autodesk Certified User (Përdorues i certifikuar i Autodesk), OSHA 10 (e përgjithshme)
NOCTI: Teknologjitë e inxhinierisë PA
Organizata e nxënësve CTE: Skills USA
Vendndodhjet: Kensington, Science Leadership Academy,

Mirëmbajtja e strukturave dhe pronave

Ky program mësimor i përgatit individët për të zbatuar njohuritë dhe aftësitë teknike për ta mbajtur një ndërtesë funksionale dhe për t'i shërbyer një sërë strukturash, duke përfshirë ndërtesat tregtare dhe industriale, si dhe shtëpitë e lëvizshme. Mësimi përfshin bazat e zdrukthëtarisë, punimit të drurit, shërbimeve hidraulike, lysterjes, lustrimit, rrymës elektrike, svatimit, saldimit, punimit të llamarinave të vogla, hedhjes së betonit, shtrimit të tullave, vendosjes së pllakave, përdorimit të pajisjeve, sistemit të ngrohjes, ajrosjes, hidroizolimit, çatisë dhe mbajtjes së regjistrave. I jepet rëndësi e veçantë mirëmbajtjes së linjave të prodhimit dhe sistemeve të prodhimit për vendin e punës modern të ditëve të sotme.

Certifikimet e industrisë: HBI/ Residential Construction Academy Building Construction Tech (HBI/ Akademia për ndërtimin e banesave - Teknika e konstruksionit të ndërtesave), OSHA 10 Construction (OSHA 10 për ndërtimin)
NOCTI: Mirëmbajtja e Ndërtesave/Pronave PA
Organizata e nxënësve CTE: Skills USA
Vendndodhja: Dobbins, Benjamin Franklin, dhe Lincoln

Dizajni i modës

Ky program mësimor i prezanton nxënësit me një gamë të gjerë drejtime karrierash që lidhen me menaxhimin, prodhimin dhe shërbimet e veshjeve dhe tekstilit. Programi përfshin, por nuk kufizohet në thurjen, pëlhurat dhe kujdesin ndaj tyre, dizajnimin e motiveve, parimet në thurjen dhe përzgjedhjen e veshjeve, përshtatjet dhe ndryshimet e veshjeve të gatshme, shërbime robaqepësie me porosi dhe mirëmbajtjen e veshjeve. Nxënësit mësojnë tregtimin e veshjeve të modës dhe menaxhimin e shitjes me pakicë të veshjeve, së bashku me njohuritë se si të zhvillojnë, analizojnë dhe zbatojnë strategjitë e shitjeve. Mësimi mbulon praktikën e blerjes me pakicë, kontrollin e inventarit dhe analizën e kontrollit të kostos. Gjatë gjithë programit, nxënësit inkurajohen të sfidojnë aftësitë e tyre krijuese artistike për të dizajnuar, prodhuar dhe shfaqur talentet e tyre.

Certifikimet e industrisë: OSHA 10
NOCTI: Teknologjia e modës
Organizata e nxënësve CTE: DECA
Vendndodhja: Dobbins

Prodhimi i filmave dhe videove

Ky program mësimor i prezanton nxënësit me artin dhe shkencën e Prodhimit dixhital të filmave dhe videove. Nxënësit mësojnë disa lloje prodhimesh mediatike duke zhvilluar një kuptim të plotë të harduerit, softuerit dhe pajisjeve të nevojshme për të ofruar prezantime efektive për biznesin, industrinë dhe argëtimin. Mësimi përfshin trajnimin në dizajnimin e koncepteve, shkrimin e skenarit, prodhimin e videove, prodhimin televiziv, prodhimin audio, teknologjinë kompjuterike elektronike të imazhit, , të montimit, televizionit kabllor, krijimin e DVD-ve dhe prezantimit. Mësohen një sërë aplikacionesh softuerësh kompjuterikë të përditësuar duke përfshirë Adobe Premiere, Adobe Photoshop, Final Cut Pro, Soundtrack Pro, DVD Studio Pro, Final Draft dhe Microsoft Power Point. Duke përdorur teknologjinë më të fundit dixhitale, nxënësit do të zbatojnë njohuritë e tyre për të krijuar prodhime cilësore mediatike për transmetimet kabllore dhe televizive, DVD, uebin, komunikimet video të korporatave dhe teknologjinë e prezantimit bazuar në kompjuter. Ky program do të përmirësojë aftësitë e nxënësve për njohuri kompjuterike dhe komunikim, si dhe do të shërbejë si një portofol personal në përgatitje për kolegjin, biznesin dhe punësimin.

Certifikimet e industrisë: Adobe Certified Associate Photoshop and Premiere Pro (Përdorues i certifikuar Adobe Photoshop dhe Premiere Pro)
NOCTI: Produksione televizive
Organizata e nxënësve CTE: Skills USA
Vendndodhjet: Edison, Lincoln, Mastbaum, Roxborough, dhe Science Leadership Academy

Përpunimi dhe shkenca e ushqimit

Nxënësit në këtë program studiojnë sistemet ushqimore nga "Ferma në Tavolinë", duke marrë parasysh prodhimin, përpunimin dhe përgatitjen e produkteve ushqimore të sigurta, ushqyese dhe të këndshme për popullsinë në rritje të botës. Konceptet në themel të programit përfshijnë kiminë dhe mikrobiologjinë e ushqimit, konservimin dhe trajtimin e sigurt të ushqimit, si dhe vlerat e tij ushqyese. Nxënësit gjithashtu marrin parasysh etiketimin dhe materialet e paketimit të ushqimit, vlerësimin ndijor të produkteve dhe praktikat kulturore që lidhen drejtpërdrejt me prodhimin dhe konsumin e produkteve ushqimore. Ndër industritë në të cilat të diplomuarit e këtij programi do të kenë qasje janë teknologjia ushqimore dhe produktet ushqimore, të ushqyerit/dietologjia, sigurimi i cilësisë dhe inspektimet e cilësisë, si dhe marketingu dhe prokurimi i ushqimeve.

Certifikimet e industrisë: ServSafe Food Handler and Food Safety Manager (Trajtues i produkteve ushqimore ServSafe dhe menaxher i sigurisë ushqimore)
NOCTI: (nuk ka - kërkesë e tërhequr nga shteti)
Organizata e nxënësve CTE: FFA; Jr. MANRRS (Minorities in Agriculture, Natural Resources and Related Sciences [Minoritetet në bujqësi, burime natyrore dhe shkenca të ngjashme])
Vendndodhja: Saul

Dizajn grafik

Ky program mësimor ju ofron nxënësve njohuritë, aftësitë dhe një portofol të nevojshëm për të trajtuar me sukses sfidat e ndjekjes së mësimin në kolegje ose për të ndjekur një karrierë si dizajner grafik i pavarur. Kjo industri kërkon përdorimin e softuereve të specializuara, si Adobe Creative Suites, kombinuar me krijimtarinë, dizajnin dhe aftësitë e zgjidhjes së problemeve për të krijuar mesazhe vizuale dhe komunikim. Programi fokusohet në zhvillimin e krijimtarisë dhe aftësive softuerike të nevojshme për të qenë konkurrues në fushën e dizajnit grafik. Nxënësit mësojnë gjithashtu parimet, materialet dhe aftësitë e nevojshme për t'i dhënë një problemi të dizajnit një zgjidhje logjike. Gjatë vijimit të mësimin të tyre, nxënësit përqendrohen në zhvillimin e të kuptuarit të bazave të dizajnit. Duke përdorur teknologjinë më të fundit dixhitale, nxënësit marrin pjesë në aktivitete si Panairi Kombëtar i Kompjuterave dhe konkurse të tjera që ju japin mundësinë t'i zbatojnë këto parime në një sërë problemesh të dizajnit. Mbulimi i kursit përfshin konceptet e dizajnit vizual, teorinë e ngjyrave, vizatimin, tipografinë, prodhimin e printimit, reklamën, dizajnin e korporatës, dizajnin e publikimeve, dizajnin e paketimeve, dizajnin e faqes ueb dhe fotografimin. Aftësitë e dizajnit kompjuterik janë të integruara në lëndë të ndryshme gjatë gjithë programit.

Certifikimet e industrisë: Adobe Certified Associate - Photoshop, InDesign, and/or Illustrator (Përdorues i certifikuar i Adobe - Photoshop, InDesign, dhe/ose Illustrator)
NOCTI: Arti tregtar dhe i reklamimit PA
Organizata e nxënësve CTE: Skills USA
Vendndodhjet: Dobbins, Edison, Mastbaum, Roxborough, dhe South Philadelphia

Teknologji e lidhur me shëndetin

Ky program mësimor i përgatit individët për të zbatuar njohuritë dhe aftësitë në profesionet shëndetësore. Ofrohet mësimi i aftësive bazë në një sërë fushash që lidhen me profesionet e shëndetësisë si shërbimet shëndetësore dhe mjekësore, instrumentet dhe furnizimet farmaceutike dhe mjekësore. Mësimi përfshin, por nuk kufizohet në bazat e shëndetësisë (terminologjia mjekësore); anatominë dhe fiziologjinë; aspektet ligjore, etike dhe ekonomike të kujdesit shëndetësor; procedurat laboratorike klinike; aftësitë profesionale shëndetësore bazë; teknikat aseptike; rregulloret e OSHA-së; dhe kontrollin e infeksionit. Edukimi klinik është pjesë integrale e programit. Shkenca dhe matematika e mësuar nga mësues të certifikuar të shkencave dhe matematikës do të koordinohen dhe do të konsiderohen thelbësore për nxënësit në mënyrë që të arrijnë me sukses objektivat e tyre të karrierës.

Certifikimet e industrisë: BLS Healthcare Provider (Ofruesi i kujdesit shëndetësor BLS (CPR & AED)), Heartsaver First Aid (Ndihma e parë Heartsaver), HIPAA, Personal Care-Direct Care Staff Person (Person i stafit për kujdesin personal - kujdesin direkt (PA Dept. i shërbimeve njerëzore)), OSHA Healthcare (OSHA për shëndetësinë)
NOCTI: Asistenca shëndetësore
Organizata e nxënësve CTE: HOSA
Vendndodhjet: Edison, Kensington Health Sciences Academy, Lincoln, King, Mastbaum, Randolph, Sayre, dhe Swenson

Hortikultura

Hortikultura është dega e shkencës që merret me artin, teknologjinë dhe biznesin e rritjes së bimëve, si edhe vëmendjen ndaj biologjisë dhe kimisë. Ajo mbulon kultivimin e barërave, pemëve dhe bimëve dekorative, si dhe bimëve mjekësore, frutave, perimeve, arrave, barishteve, luleve dhe filizave. Detyrat e kursit do të përqendrohen te botanika, shkenca e tokës, entomologjia dhe rëndësia e bimëve në jetën tonë, por nxënësit do të kenë gjithashtu shumë mundësi për të "ndotur duart", duke zhvilluar aftësi në kopshtarinë bazë dhe kujdesin për tokën, projektimin dhe ndërtimin e peizazhit, si dhe menaxhimin e serave. Një formim në Hortikulturë mund të çojë drejt një karriere në mbarështimin e bimëve, inxhinierinë gjenetike, dizajnin e peizazhit, bujqësinë, dizajnin e luleve, kërkimin shkencor, prodhimin e fidanishteve, arsimin, shkencën e ushqimit, si dhe ndërtimin dhe menaxhimin e peizazhit.

Certifikimet e industrisë: OSHA 10 (e përgjithshme)
NOCTI: Hortikultura e aplikuar PA
Organizata e nxënësve CTE: FFA
Vendndodhjet: Saul

Mikpritja, udhëtimi dhe turizmi

Programi i Menaxhimit të Mikpritjes dhe Turizmit është një program mësimor që i përgatit nxënësit në një sërë funksionesh marketingu dhe menaxheriale dhe përgjegjësish operacionale që lidhen me një gamë të gjerë karrierash në industrinë e mikpritjes, udhëtimit dhe turizmit. Nxënësit do të marrin mësim për fushat e menaxhimit të rezortëve, zhvillimit personal, mirëmbajtjes së ambienteve, komunikimit, operacioneve të zyrës së shërbimeve për klientin, udhëheqjes, shërbimeve të mysafirëve, shitjeve, proceseve financiare, shërbimit të ushqimit dhe pijeve, menaxhimit të strukturave, sigurisë/mbrojtjes së pronës dhe aktivitete të tjera profesionale që do të zhvillojnë nxënësit në kompetencat e nevojshme për punësim në industrinë në rritje të Mikpritjes, Udhëtimit dhe Turizmit.

Certifikimet e industrisë: OSHA 10 (e përgjithshme)

NOCTI: Menaxhimi i Mikpritjes-Akomodimi
Organizata e nxënësve CTE: DECA
Vendndodhjet: Frankford High School

Menaxhimi i logjistikës, materialeve dhe rrjetit të furnizimit

Ky program mësimor i përgatit individët për të menaxhuar dhe koordinuar funksionet logjistike në një ndërmarrje dhe për të marrë përsipër përgjegjësitë e lidhura me marrjen, ruajtjen, dërgimin, kontrollin dhe shpërndarjen e produkteve dhe materialeve, si dhe sistemeve të ndryshme dhe mbajtjen e inventarëve që kanë të bëjnë me këto veprime. Nxënësit do të udhëzohen për përdorimin e hapësirës së ruajtjes, kontrollin e inventarit, praktikën e transportit dhe të pranimit; si dhe përdorimin e mjeteve si pirunët, transportuesit shirit, karrocën e dorës, karrocën dhe pajisjet e tjera që përdoren për të transportuar materiale dhe/ose furnizime në destinacione të ndryshme. Nxënësve ju mësohen llojet e shumta të dokumenteve të përdorura në logjistikë si urdhrat e blerjeve, faturat, policat e porosive, kërkesat, kuotimet, etj. Nxënësit mësojnë gjithashtu për fushat e tarifave dhe normave të mallrave, rregullat e klasifikimit të mallrave dhe analizën e tarifave të mallrave.

Certifikimet e industrisë: OSHA 10 (të përgjithshme), S/P2 - Shipping Hazardous Materials (S/P2 - Transporti i materialeve të rrezikshme)
NOCTI: Teknologjia e logjistikës
Organizata e nxënësve CTE: DECA
Vendndodhja: Edison

Asistent mjekësor/klinik

Ky program mësimor i përgatit individët për të ndihmuar mjekët duke kryer funksione të lidhura me detyrat administrative dhe klinike të një zyre mjekësore. Komponentët administrativë të mësimin përfshijnë teknikën telefonike, sigurimin, llogaritë, raportet, regjistrat mjekësore, menaxhimin fiskal të kompjuterizuar, transkriptimin mjekësor dhe përpunimin e tekstit. Aspektet klinike të programit ofrojnë udhëzime në teknikat e sallës së ekzaminimit, praktikën aseptike, kontrollin e infeksionit, kujdesin për pajisjet dhe furnizimet, CPR dhe ndihmën e parë, orientimin laboratorik dhe përdorimin e pajisjeve biomjekësore. Plani mësimor përfshin kurse të planifikuara në anatomi dhe fiziologji, masazh paraprak universale dhe rregulloret e OSHA-së, terminologjinë mjekësore, ligjin dhe etikën mjekësore, psikologjinë, komunikimin, hyrjen në farmakologji, aftësitë e asistencës mjekësore dhe praktikën klinike.

Certifikimet e industrisë: BLS Healthcare Provider (Ofruesi i kujdesit shëndetësor BLS (CPR & AED)), Heartsaver First Aid (Ndihma e parë Heartsaver), HIPAA, Medical Assisting Clinical & Clerical (Asistencë mjekësorë, klinike dhe klerike), OSHA Healthcare (OSHA për kujdesin shëndetësor)
NOCTI: Asistencë mjekësore
Organizata e nxënësve CTE: HOSA
Vendndodhja: Franklin Learning Center, Olney

Teknologjia e rrjetit hidraulik

Ky program mësimor i përgatit individët për të ushtruar profesionin si hidraulikë të licencuar duke zbatuar njohuritë teknike, sigurinë dhe aftësitë për të vendosur, montuar, instaluar dhe mirëmbajtur pajisjet hidraulike dhe sistemet për avull, gaz natyror, vaj, ujë të nxehtë, sistemet e ngrohjes, ftohjes, kullimit, lubrifikimit, spërkatjes dhe sistemet e përpunimit industrial në ambientet e banimit dhe të biznesit.

Përfshin mësim për përcaktimin e burimit, shpërndarjen e ujit, heqjen e mbeturinave, rregullimin e presionit, fizikën bazë, matematikën teknike, leximin e planimetrisë, instalimin e tubave, pompat, ngjitjen dhe saldimit, inspektimin e rrjetit hidraulik dhe kodet dhe standardet e zbatueshme.

Certifikimet e industrisë: OSHA 10 Construction (OSHA 10 për ndërtimin), HBI/ Residential Construction Academy Plumbing (Basic & Advanced) (HBI/ Akademia për ndërtimin e banesave - rrjeti hidraulik (bazë dhe e avancuar))
NOCTI: Teknologjia e rrjetit hidraulik PA
Organizata e nxënësve CTE: Skills USA
Vendndodhja: Edison dhe Mastbaum

Teknologjia e veglave të makinerive me precizion

Ky program mësimor është krijuar për të përgatitur nxënësit që të zbatojnë njohuritë dhe aftësitë teknike në të gjitha aspektet e formësimin të pjesëve metalike. Mësimi përfshin llogaritjen e dimensioneve të punës, veglat dhe furnizimet dhe shpejtësitë e përpunimit. I jepet vëmendje e veçantë punës në fabrikë dhe përdorimit të tornove, sharrave elektrike, formësuesve, makinave të punimit të drurit, grirësve, trapanëve dhe pajisjeve kompjuterike (CNC/CIM). Mësimi përfshin gjithashtu përdorimin e instrumenteve matëse precize si mjettet e strukturës, mikrometrat dhe matësit; metodat e përpunimit dhe të trajtimit termik të metaleve të ndryshme; leximin e planimetrisë; dhe paraqitjen e pjesëve të makinerisë. Mësimi i përgatit nxënësit të përdorin të gjitha llojet e makinerive manuale dhe kompjuterike.

Certifikimet e industrisë: OSHA 10 (e përgjithshme), NIMS (National Institute for Metalworking Skills [Instituti Kombëtar për Aftësitë e Përpunimit të Metaleve])
NOCTI: Nuk ka – Nxënësit bëjnë provimin NIMS
Organizata e nxënësve CTE: Skills USA
Vendndodhja: Benjamin Franklin

Shitjet, marketingu dhe sipërmarrja

Ky program mësimor i përgatit individët me mundësi praktike për t'u përgatitur për një karrierë në fushën e shitjeve, marketingut dhe sipërmarrjes duke marrë ekspertizë në lidhje me shërbimin ndaj klientit, hapat e procesit të shitjes, shitjen e veçorive/përfitimeve, dhe aftësitë soft të nevojshme për vendin e punës. Programi fokusohet në 7 funksionet e marketingut, të kuptuarit e klientit dhe si të tregtoni dhe promovoni një biznes. Mësimet e thelluara përfshijnë markën, ekonominë, sipërmarrjen, etikën, konceptet e menaxhimit dhe marketingut, komunikimin dhe burimet njerëzore. Mësimi përfshin mediat sociale, menaxhimin e marketingut dhe teknologjinë e biznesit me aplikacionet e Microsoft dhe Google.

Certifikimet e industrisë: Microsoft Office Specialist (Specialist i Microsoft Office (Excel)), National Retail Federation (NRF) Business of Retail and Customer Service & Sales Certified Specialist (Federata Kombëtare e Shitjes me Pakicë (NRF), Specialist i Certifikuar i Biznesit të Shitjes me Pakicë, Shërbimit ndaj Klientit dhe Shitjeve), Meta Certified Digital Marketing Associate (Përdorues i certifikuar i marketingut dixhital të Meta)
NOCTI: Shërbimet e shitjes, shpërndarjes dhe marketingut PA
Organizata e nxënësve CTE: DECA
Vendndodhjet: Kensington, Lincoln, Mastbaum, Northeast, Roxborough, dhe Washington

Teknologjitë e energjisë diellore

“Bright Solar Futures” është një program që i përgatit nxënësit për mundësitë e karrierës në industrinë e energjisë diellore dhe efikasitetit të energjisë. Nxënësit do të fillojnë duke eksploruar konceptet themelore të energjisë së rinovueshme, efikasitetit të energjisë dhe praktikave të sigurisë së ndërtimit. Më pas, përmes një kombinimi të mësimit në klasë, trajnimit praktik në një laborator më të avancuar, udhëtimeve në terren dhe prezantimeve nga profesionistë të fushës, nxënësit do të mësojnë se si të menaxhojnë dhe dizenojnë projekte diellore dhe si të kryejnë instalimet diellore dhe punët e përkatëse të ndërtimit duke përfshirë klimatizimin dhe punën e instalimeve elektrike. Përveç kësaj, nxënësit do të zhvillojnë të kuptuarit e evolucionit të industrisë së energjisë diellore dhe teknologjive të komponentëve, si dhe implikimet e biznesit dhe financiare të efikasitetit dhe ruajtjes së energjisë, në mënyrë që ata të kenë një gamë të plotë drejtimesh në të cilat mund të ngrenë karrierën e tyre.

Certifikimet e industrisë: NABCEP Associate (Përdorues i NABCEP); OSHA 10 General Industry (OSHA 10 për industrinë e përgjithshme)

NOCTI: (nuk ka - kërkesë e tërhequr nga shteti)

Karriera dhe organizata teknike e nxënësve: Skills USA

Vendndodhjet: Randolph

Ndihmës mjekësor/rehabilitimit sportiv

Ky program mësues i përgatit individët që të asistojnë në shërbimet e rehabilitimit nën mbikëqyrjen e terapistëve fizikë, terapistëve profesionistë dhe profesionistëve të tjerë terapeutikë. Për më tepër, programi i përgatit individët që të kryejnë funksione rutinë në mbështetje të rehabilitimit. Përfshin mësime për rolet dhe përgjegjësitë e ofruesve të rehabilitimit, funksionin bazë të trupit të njeriut, kushtet e aftësisë së kufizuar, aftësitë terapeutike, menaxhimin e klientit dhe aftësitë e komunikimit.

Certifikimet e industrisë: BLS Healthcare Provider (Ofruesi i kujdesit shëndetësor BLS (CPR & AED)), Heartsaver First Aid (Ndihma e parë Heartsaver), HIPAA, OSHA 10 Healthcare (OSHA 10 për shëndetësinë), Personal Care - Direct Care Staff Person (Personi i stafit për kujdesin personal - kujdesin direkt), Stop the Bleed (Ndalimi i gjakderdhjes), Concussion Wise (Për tronditjet)

NOCTI: Ndihma për rehabilitimin PA

Organizata e nxënësve CTE: HOSA

Vendndodhjet: Kensington Health Sciences Academy, Olney, dhe South Philadelphia

Teknologjia e saldimit

Ky program mësues i përgatit nxënësit të zbatojnë njohuritë dhe aftësitë teknike për metodat e saldimit: saldimit me gas, me hark, me hark metalik me mburojë dhe pa mburojë, saldimit me mbushje, prerjen me flakë dhe saldimit me plazmë. Në mësim përfshihen edhe proceset e saldimit me dorë, gjysmë-automatike dhe automatike. Nxënësit mësojnë praktikën e sigurisë dhe llojet dhe përdorimet e elektrodave dhe shufrave të saldimit; vetitë e metaleve; leximin e planimetrisë; parimet elektrike; simbolet e saldimit dhe vizatimin mekanik; përdorimin e pajisjeve për testimin e saldimeve me metoda ultrasonike dhe testimin e shkatërrimit dhe fortësisë; përdorimin e manualeve dhe tabelave të specifikimeve; përdorimin e bluarësve portativë dhe banjave kimike për pastrimin e sipërfaqeve; pozicionimin dhe shtrëngimin; dhe standardet e saldimit

të vendosura nga American Welding Society (Instituti Amerikan i Saldimit), American Society of Mechanical Engineers (Instituti Amerikan i Inxhinierëve Mekanikë) dhe American Bureau of Ships (Byroja Amerikane e Anijeve).

Certifikimet e industrisë: American Welding Society (Instituti Amerikan i Saldimit) (AWS) Entry Welder & Advanced Welder (Saldues fillestar dhe saldues i avancuar), OSHA 10 Construction (OSHA 10 për ndërtimin)

NOCTI: Saldimi

Organizata e nxënësve CTE: Skills USA

Vendndodhjet: Edison, Benjamin Franklin, Mastbaum, dhe Randolph

21st Century Schools

Modeli i "21st Century Schools" (21C) përbëhet nga modele mësimore dhe eksperimentale të përshtatura për të përgatitur nxënësit për gatishmërinë pas shkollës së mesme. Këto modele ju mundësojnë nxënësve të zgjedhin një drejtim karriere kur hyjnë në shkollën e mesme, të përqendruar në përvojat e bazuara në punë, përdorimin e metodave të teknologjisë novatore, drejtimit me udhëheqës, mësimin bazuar në projekte, llojet e ndryshme të vlerësimit dhe zbatimit të mësimin, si dhe kurse të përshtatura ndaj kërkesave të diplomimit, punësimit pas shkollës së mesme, arsimin pas shkollës së mesme, ose një kombinim të tyre.

Për më tepër, ky model integron zotërimin e përmbytjes që ju mundëson nxënësve të kenë qasje të vazhdueshme në aftësitë e të menduarit kritik: përmbledhjen, vlerësimin dhe prodhimin. Nxënësit në "21st Century Schools" mësojnë në një klasë globale që zgjerohet përtej katër mureve tradicionale. Nëpërmjet kësaj përvoje në klasë të kombinuar me atë në terren, nxënësit janë në gjendje të tregojnë aftësinë e tyre për të artikuluar dhe zbatuar atë që mësojnë në klasë në drejtimin e tyre specifik të karrierës. Gjithashtu, shfrytëzimi i trajnimit nga terreni në klasë rrit përgatitjen që inkurajon suksesin e nxënësve. Ekspozimi i kombinuar ju ofron nxënësve një perspektivë katër dimensionale, duke krijuar një themel konkret të ndërtuar përmes: (1) mësimin, (2) ndërgjegjësimin, (3) ekspozimit dhe (4) përvojës; dhe i lejon nxënësit të zhvillojnë këmbënguljen dhe vendosmërinë në lidhje me përvojat e karrierës.

Ne kemi identifikuar tre shkolla që do të marrin pjesë në modelin e shkollave "21st Century Schools": Bartkam High School, West Philadelphia High School, dhe Overbrook High School. Çdo shkollë do të fokusohet në një industri që ka kërkesë të lartë në rajonin e Filadelfias dhe përfshin, por nuk kufizohet në:

- **Transportin dhe logjistikën ([Bartkam HS](#))** duke përfshirë: Automobilit (përplasja dhe riparimi), Menaxhimin e furnizimit/Logjistikë, Magazinimin (*CDL), Transporti (ajror, hekurudhor, rrugor).
- **Zhvillimin urban ([West Phila HS](#))** duke përfshirë: Pronat imobiliare (rezidenciale, tregtare, industriale, tokat e lira, dhe përdorimin e veçantë), Teknologjinë e informacionit (riparimin e kompjuterave), Studimin e artit dhe kulturës, Sipërmarrjen.
- **Argëtimin ([Overbrook HS](#))** duke përfshirë: Dizajnin dixhital, filmin dhe televizionin, industrinë e muzikës, menaxhimin e argëtimit.

Atletika

Divizioni i Atletikës është përgjegjës për koordinimin dhe zbatimin e programeve të atletikës për shkollat publike dhe shkollat publike të pavarura nga Qarku në Rrethin Shkollor të Filadelfias, si dhe për pajtueshmërinë me shoqatën e atletikës shtetërore (PIAA) dhe udhëzimet federale (të tilla si Barazia Gjinore, Titulli IX).

Pjesëmarrja në aktivitetin atletik ka treguar se rezultoni në përmirësim në shumë fusha, duke përfshirë frekuentimin në shkollë, suksesin akademik, shëndetin dhe mirëqenien, vetëvlerësimin, lidhjen me bashkëmoshatarët dhe shkollën, standarde të larta të sjelljes dhe qëndrimit, punën në grup dhe sportivitetin.

Për këto arsye, të gjithë nxënësit e klasës së nëntë duhet të planifikojnë të marrin pjesë në aktivitete jashtëshkollore, duke përfshirë atletikën. Nxënësit duhet të jenë të vetëdijshëm që duhet të përmbushen standardet minimale akademike të Shoqatës Atletike Ndërskollore të Pensilvanisë (PIAA) për të marrë

pjesë në Atletikë dhe se ekzistojnë gjithashtu kërkesa të veçanta për bursat që variojnë sipas institucionit. Ju lutemi, konsultohuni me këshilltarin tuaj të shkollës së mesme dhe drejtorin atletik për më shumë informacion. Divizioni i Atletikës viziton rregullisht shkollat e mesme dhe paraqet informacionin e pajtueshmërisë së NCAA-së.

PIAA-ja kërkon që të kryhet një Provim Fizik Fillestar Gjithëpërfshirës Para-Pjesëmarrjes (CIPPE) në ose pas datës 1 maj të çdo viti shkollor.

Për më shumë informacion, ju lutemi kontaktoni Drejtorin Atletik të shkollës suaj.

Shkollat e mesme në Rrethin Shkollor të Filadelfias ofrojnë një përzgjedhje interesante të programeve atletike pas shkollës. Ofertat specifike ndryshojnë në çdo shkollë të mesme; nxënësit dhe familjet e tyre inkurajohen të mësojnë rreth opsioneve të disponueshme duke vizituar faqen ueb të shkollës së mesme.

Sportet që mund të ofrohen në çdo shkollë të mesme përfshijnë:

Sezoni i vjeshtës

- Cross Country (për djem dhe vajza)
- Hokej në fushë
- Futboll amerikan
- Golf
- Futboll (për djem)
- Futboll (për vajza)
- Tenis (për vajza)
- Volejbol (për vajza)

Sezoni i dimrit

- Basketboll (për djem)
- Basketboll (për vajza)
- Bowling (për djem dhe vajza)
- Shpirt konkurrues (nxitje e tifozëve)
- Atletikë në ambiente të brendshme (për djem dhe vajza)
- Not (për djem dhe vajza)
- Mundje

Sezoni i pranverës

- Badminton (për vajza)
- Bejsboll
- Futboll amerikan Flag (vajza)
- Lacrosse (për djem)
- Lacrosse (për vajza)
- Softboll
- Tenis (për djem)
- Atletikë (për djem dhe vajza)
- Volejbol (për djem)

Për më shumë informacion për Divizionin e Atletikës në Rrethin Shkollor të Filadelfias, na kontaktoni në numrin (215) 400-4190, na dërgoni email në athletics@philasd.org, dhe/ose vizitoni faqen tonë ueb: <https://www.philasd.org/athletics/>.

Profilet e shkollave të mesme

Academy at Palumbo High School

<https://palumbo.philasd.org/>

**1100 Catharine Street
Philadelphia, PA 19147**

Drejtori:

Kiana L. Thompson
klthompson@philasd.org

Telefoni: 215-400-8130

Faks: 215-400-8131

Regjistrimi i nxënësve: 1,230

Kriteret e pranimit:*

Notat:

A dhe B (për katër lëndët bazë:
ELA, matematikë, shkencë dhe
studime sociale)

Frekuentimi:

95% (9 ose më pak mungesa
pa arsye)

Testet e standardizuara:

65 përqind ose më shumë në
ELA dhe matematikë

Faqja ueb:

Për më shumë informacion,
ju lutemi vizitoni: [https://
palumbo.philasd.org/parents/
applications-and-transfers/](https://palumbo.philasd.org/parents/applications-and-transfers/)

*Për më shumë detaje rreth
kriterëve individuale të shkollës,
vizitoni schoolselect.philasd.org

Rrugët SEPTA:

32, 45, 64, C, 27, 47, Broad
Street Subway



Misioni dhe qasja ndaj mësimit:

E themeluar në vitin 2006, Academy at Palumbo synon të krijojë një komunitet të larmishëm intelektual që synojnë të vazhdojnë kolegjin, besimet thelbësore ë të cilëve mishërojnë respektin dhe mirëpritjen e diversitetit. Si një shkollë përgatitore për kolegjin, e bazuar në kriteret, misioni i "The Academy at Palumbo" është t'u sigurojë nxënësve tanë përgatitjen më gjithëpërfshirëse dhe intensive të disponueshme në sektorin publik, për sa i përket rigorozitetit të arsimit të lartë. Si pjesë integrale e kësaj përgatitjeje, misioni i Akademisë përfshin ngritjen e aspiratave të çdo nxënësi, zhvillimin e teknikave universale të zgjidhjes së problemeve, aftësive teknologjike dhe rrënjosjen e një pasioni të përjetshëm për të mësuar, duke përfshirë një përvojë të pasur të arteve të kulturës.



Pikët e krenarisë:

- Pesë intelektual të Questbridge nga klasa e diplomimit të 2024
- Ka fituar vendin e 1-rë në 4 kategori, të 2-in në 2 kategori të konkursit PA Media & Design City
- Fitues për të parën herë i vendit të 1-rë i kampionatit -- PIAA Girls Flag Football
- Konkurrues kombëtar në "Speech & Debate"
- Tridhjetë e tre nxënës fituan "Seal of Biliteracy"
- Çmimi Silver i Guvernatorit për Angazhimin Civil
- Qarku 12 mban rekordin për 4x100 relay (stafetë) për vajza
- Nxënësja e parë femër që ka fituar çmimin Mini Max në futboll amerikan
- Nxitëset e tifozëve fituan vendin e 1-rë në konkursin e nxitësve të tifozëve në Lincoln University
- Mësuesi i shkencës kompjuterike mban çmimin Drexel's Behind Every Teacher
- Trajnerja e vitit për atletikën e lehtë brenda dhe jashtë në terren është trajnerja femër e Philadelphia High School
- Grupi i poezisë është 6 herë kampion
- Programet e volejbollit me vlerësimin më të lartë për djem dhe vajza
- Active Home & School Association
- National Honor Society
- Anëtarë të korit dhe orkestrës së qytetit



Pikat kryesore të kurseve dhe programit:

- **Kurset Advanced Placement:**
 - Histori afro-amerikane
 - Art (2D, 3D, vizatim)

- Biologji
- Aritmetikë AB
- Kimi
- Gjuhë kineze
- Krahasim sistemesh qeverisëse
- Shkenca kompjuterike A
- Parimet e shkencave kompjuterike
- Gjuhë angleze dhe hartim
- Letërsi angleze dhe hartim
- Historia evropiane
- Qeveritë dhe politikë
- Teori muzike
- Fizikë B
- Aritmetikë e thjeshtuar
- Psikologji
- Gjuha spanjolle
- Statistikë
- Historia e SH.B.A-së

- **Regjistrimi i dyfishtë:** Programi i regjistrimit të dyfishtë në vend (on-site) përmes Harrisburg University
- Kërcim
- Teatër
- Muzikë kori dhe instrumentale
- Philadelphia Financial Scholars



Partneritetet:

- Artists in Schools - The Print Center
 - ASAP Chess (shah)
 - ASAP Debate
 - ASAP Scrabble
 - City Commissioners Office (numërues votash)
 - Coded By Kids
 - College Possible
 - Curtis Institute of Music (Instituti i muzikës Curtis)
 - eClose Institute/I njohur më parë si programi Immersion Science
 - EF Tours (udhëtime verore jashtë vendit)
 - Fearless Athletics
 - Biblioteka publike e Filadelfias, Seritë e autorëve adoleshentë
 - Generation Citizen (Shkencat Sociale, Angazhimi Qytetar)
 - Harrisburg University
 - Muzeu i ndërgjegjësimit për Holokaustin dhe qendra e edukimit
 - Shërbimet për familjet hebraike dhe fëmijët e Greater Philadelphia
 - Udhëtim në Lotus
 - Lantern Theater Company
 - Metropolitan Opera
 - Museum of Black Joy
- vazhdon në faqen tjetër

- Music and the Brain
- Mutter Museum (udhëtime dhe seminare)
- Office of Vocational Rehabilitation
- Opera Philadelphia
- PASH Sexual Health Education
- PA Youth Vote (Regjistrimi i votuesve)
- Penn Law School (Imitim gjyqi)
- Penn Museum (udhëtime dhe seminare të sponsorizuara çdo vit)
- Penn Project for Philosophy for the Young (filozofë të brendshëm, Ethics Bowl)
- Philadelphia Bar Association
- Philadelphia Chamber Music Society
- Philadelphia Financial Scholars
- Philadelphia Orchestra
- Philadelphia Robotics Coalition
- Philadelphia Young Playwrights
- Philly BOLT (Shkenca Sociale, Angazhimi Qytetar)
- Philly Slam League
- Project Launch
- Steve's Club
- Students Run Philly Style
- Teacher's Institute of Philadelphia (Instituti i mësuesve të Filadelfias)
- Temple University
- The Cliffs at Callowhill Climbing Gym (klubi i ngjijtes)
- University of Pennsylvania Law School
- University of Pennsylvania My Climate Story
- University of the Arts
- VietLead (Angazhimi Qytetar)
- Villanova University
- Wilma Theater
- Women Against Abuse
- World Cafe Live Education dhe Engagement Programs
- Young People's Concert Series në The Mann Center
- Gjykata për të rinjtë



Aktivitetet jashtëshkollore:

- Klubi i aventurave
- Arte dhe vepra artizanale
- Sindikata e nxënësve me ngjyrë
- Klubi i librit
- Klubi i bamirësisë
- Kori
- Klub për mjedisin
- GSA
- Klubi i muzikës instrumentale
- KPOP

- Klubi i arteve mediatike dhe i programimit
- Klubi mjekësor
- Imitim gjyqi
- Shoqata e Nxënësit Mysliman
- Ekipi i lajmeve
- NHS
- Klubi i shërbimeve për personat në nevojë
- Klubi i ping pongut
- Klubi / ekipi i poezisë
- Grupi i rokut
- Klub shahu
- Robotikë
- Olimpiada e shkencës
- Klub Scrabble
- Ekipi i fjalimeve dhe debatit
- Klubi i kulturës aziatike
- Klubi i nxitjes së tifozëve
- Ngjitja
- Klubi i ngjitjes
- Klubi i gatimit
- Klubi i thurjes me grep/art me fibra
- FITNESS
- Gazeta Griffin Gazette
- Sindikata e etnitetit hispanik dhe latin
- Klubi i detyrave
- Grupi i rokut
- Klubi i kubit të Rubikut dhe stivimit të gotave
- SWAV
- Klubi i video lojërave
- Klubi i kopshtarisë



Ekipe sportive:

- Badminton*
- Bejsboll
- Basketboll për djem dhe vajza
- Mbështetja
- Vrapë në natyrë
- Futboll amerikan*
- Futboll amerikan Flag për vajza*
- Golf
- Lacrosse për djem dhe vajza
- Futboll për djem* dhe vajza
- Softboll
- Noti
- Atletikë e lehtë për djem* dhe vajza*
- Volejbol për djem dhe vajza*
- Mundje*

*Ekipi Academy at Palumbo

Arts Academy në Benjamin Rush High School

<https://rush.philasd.org/>

11081 Knights Road
Philadelphia, PA 19154

Drejtori:

Dr. Latoya K. Bailey
labailey@philasd.org

Telefoni: 215-400-3030

Faks: 215-400-3031

Regjistrim i nxënësve: 630

Kriteret e pranimit:*

Nota:

A, B, dhe dy C (për katër
lëndët bazë: ELA, matematikë,
shkencë dhe studime sociale)

Frekuentimi:

90% (18 ose më pak mungesa
pa arsye)

Testet e standardizuara:

50 përqind ose më shumë në
ELA ose matematikë

Kërkesa shtesë:

Audiençë -Kërkohet një
audiençë e suksesshme
në drejtimin e zgjedhur
(art, vallëzim, vokal, muzikë
instrumentale ose teatër).

Faqja ueb:

Për më shumë informacion,
ju lutemi vizitoni: <https://rush.philasd.org/auditions/>.

*Për më shumë detaje rreth
kriterëve individuale të shkollës,
vizitoni schoolselect.philasd.org

Rrugët SEPTA:

20, 67, 84



Misioni dhe qasja ndaj mësimit:

Rush Arts bazohet në besimin se artet krijuese ofrojnë një mundësi të pakrahasueshme për të zhvilluar rritjen intelektuale dhe krijimtarinë personale si pjesë e një plani mësimit akademik rigoroz.

Përmes vlerave tona thelbësore, ne theksojmë rëndësinë e krijimit të një komuniteti reflektues nxënësish që janë mendimtarë kritikë, përshtaten me situatën dhe krijuen, teksa ne i përgatisim nxënësit tanë për kolegjin dhe karrierat profesionale.

Rush Arts zhvillon kapacitetin e nxënësve si anëtarë aktivë të një shoqërie demokratike qytetare duke nxitur një kulturë bisede, duke rritur respektin për pikëpamjet e ndryshme të popullatës sonë të larmishme dhe dinamike të nxënësve dhe duke i inkurajuar nxënësit që të ngrenë zërin për të fituar barazi dhe drejtësi sociale.



Pikët e krenarisë:

- 2022 Blue Ribbon School of Excellence në qytetin e Filadelfias
- Profilizuar në Philadelphia Inquirer dhe ka fituar njohje kombëtare në vende si SmartBriefs e ASCD dhe Inbox e NCTE
